BANKA E SHQIPËRISË

BULETINI EKONOMIK

Botim tremujor

Dhjetor 2003

Artikujt e paraqitur në këtë botim, nuk shprehin gjithmonë opinionin zyrtar të Bankës së Shqipërisë. Këtyre artikujve lutemi t'u referoheni si mendime personale të autorëve.

Nëse përdorni të dhëna të këtij publikimi jeni të lutur të citoni burimin.
Botuar nga : Banka e Shqipërisë, Sheshi "Skënderbej", Nr.1, Tiranë.
Tel : 355-4-222230; 235568; 235569;
Faks : 355-4-223558

Për komentet dhe sugjerimet tuaja na shkruani në:
Sektori i Publikimeve, Departamenti i Marrëdhënieve me Publikun.
public@bankofalbania.org
Shtypur në Shtypshkronjën e Bankës së Shqipërisë.
Tirazhi : 1200 kopje

BULETINI EKONOMIK TREMUJOR

DHJETOR 2003

PËRMBAJTJA

KONFERENCA E PËRBASHKËT PËR SHTYP ME MISIONIN E FMN-SË DHE MINISTRIN E FINANCAVE, 29 TETOR 2003 5

FJALA E HAPJES NË SEMINARIN "ZËVENDËSIMI I CASH-IT ME MJETE ALTERNATIVE PAGESE: AVANTAZHET DHE PROBLEMET", TIRANË, 10 NËNTOR 2003 7

FJALA NË HAPJEN E FUSHATËS KUNDËR RRITJES SPEKULATIVE TË ÇMIMEVE NË PRAG TË FESTAVE TË FUNDVITIT, 20 NËNTOR 2003 8

FJALA NË KOMITETIN NDËRMINISTROR TË POLITIKAVE TË SIGURIMIT KOMBËTAR, 24 NËNTOR 2003 10

FJALA NË KOMISIONIN PARLAMENTAR TË EKONOMISË, FINANCAVE DHE PRIVATIZIMIT NË KUVENDIN E SHQIPËRISË, 15 DHJETOR 2003 12

Programi monetar i vitit 2004, bashkëjetesa e tij me politikën fiskale. 12

Viti 2003 në shifra 12

Programi monetar i vitit 2004. 14

Inflacioni dhe politika monetare gjatë vitit 2004. 15

Supozimet kryesore të programit monetar të Bankës së Shqipërisë për vitin 2004. 15

Oferta monetare dhe përbërësit e saj. 16

Kërkesa e ekonomisë për mjete monetare 17

INTERVISTA PËR GAZETËN "SHEKULLI", 29 DHJETOR 20031
CANI: KRIZA POLITIKE, KOSTO TË RËNDA NË EKONOMI 20

FJALA NË MBLEDHJEN E KËSHILLIT MBIKËQYRËS MBI NDRYSHIMIN E NORMËS SË INTERESIT DHE EFEKTET E PRIVATIZIMIT TË BANKËS SË KURSIMEVE, 30 DHJETOR 200322

1. Mbi ndryshimin e normës bazë të interesit 22

2. Mbi efektet e mundshme të privatizimit të Bankës së Kursimeve 23

INTERVISTA PËR GAZETËN "KOHA JONË ", 30 DHJETOR 2003
CANI: SUPRIZA JONË E VITIT 2004, KREDITIMI 25

RAPORTI I ZHVILLIMEVE EKONOMIKE DHE MONETARE PËR GJASHTËMUJORIN E DYTË TË VITIT 2003 30

BULETINI I LAJMEVE TETOR-DHJETOR 2003 33

NGJARJET JURIDIKE 41

LISTA E SUBJEKTEVE TË LICENCUARA NGA BANKA E SHQIPËRISË 49

Banka dhe degë të bankave të huaja 49

Subjekte jobanka 52

Subjektet financiare që nuk licencohen nga Banka e Shqipërisë për kryerjen e veprimtarisë së tyre, në mbështetje të vendimit nr. 26, datë 29.03.2000, të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë: "Për përjashtimin e disa subjekteve nga zbatimi i dispozitave të ligjit nr. 8365, datë 02.07.1998 "Për bankat në Republikën e Shqipërisë"". 54

Zyra të këmbimeve valutore 55

Unionet e shoqërive të kursim-kreditit 61

Zyra të përfaqësimit të bankave të huaja 62

KONFERENCA E PËRBASHKËT PËR SHTYP ME MISIONIN E FMN-SË DHE MINISTRIN E FINANCAVE, 29 TETOR 2003

Gjatë dy javëve të diskutimeve intensive mes ekspertëve të Bankës së Shqipërisë dhe Misionit EU1 të Fondit Monetar Ndërkombëtar, u konkludua se ekonomia shqiptare po shënon progres në drejtim të rritjes ekonomike në përgjithësi dhe zhvillimeve makroekonomike në veçanti.

Si Guvernator i Bankës së Shqipërisë, ndava të njëjtin gjykim me shefin e Misionit z.Sammiei, se sipas parashikimeve në fund të vitit rritja ekonomike e Shqipërisë pritet të jetë 6 për qind dhe norma e inflacionit rreth 3 për qind, pra brenda intervalit të parashikuar prej 2-4 për qind.

Me kënaqësi vërej se Misioni i FMN-së dha një mbështetje të rëndësishme për reformën e sektorit financiar shqiptar dhe konsolidimin e mëtejshëm të sistemit bankar, tek i cili është rritur ndjeshëm besimi i publikut falë një politike monetare të kujdesshme, të suksesshme dhe transparente të ndjekur nga Banka e Shqipërisë.

Nga ana tjetër, me kënaqësi vërej se Banka e Shqipërisë ka plotësuar të gjitha angazhimet në kuadër të Memorandumit të Mirëkuptimit mes Autoriteteve Shqiptare dhe Fondit, si ato që i përkasin agregatëve monetarë ashtu edhe zhvillimit dhe konsolidimit të sistemit bankar.

Banka e Shqipërisë mbështet përpjekjet e Ministrisë së Financave në procesin e privatizimit të Bankës së Kursimeve, për t'i dhënë një shtysë të mëtejshme zhvillimit të sektorit bankar në Shqipëri. Sa i përket buxhetit të vitit 2004 si dhe reformave strukturore të programuara, Banka e Shqipërisë i gjykon ato të arsyeshme, realiste dhe njëkohësisht shpreh dëshirën për angazhim serioz të Qeverisë në realizimin e tyre.

Duke shfrytëzuar rastin, më lejoni të ndalem pak më gjatë në një çështje që ka të bëjë politikën monetare të Bankës së Shqipërisë. Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë në mbledhjen e sotme sapo mori vendim për të ulur me 0.5 pikë përqindjeje normën e interesit për marrëveshjet e riblerjes, duke e çuar atë nga niveli 7.5 për qind në 7 për qind. Siç mund ta kuptoni bëhet fjalë për normën bazë të interesit në ekonomi, e cila përbën dhe levën kryesore të politikës së Bankës së Shqipërisë. Dua të theksoj se pas kësaj uljeje, *de facto* përqindja e repos arrin në të njëjtin nivel me atë të parakrizës së vitit 2002, moment në të cilin Banka e Shqipërisë u detyrua të fillonte një varg rritjesh të sforcuara të përqindjes bazë të interesit.

Banka e Shqipërisë është e bindur se me anë të këtij veprimi do të ulë më tej çmimin e parasë në ekonomi, duke stimuluar akoma më shumë uljen e kostos së financimit në ekonomi.

Në gjykimin për ndërmarrjen e këtij veprimi, Banka e Shqipërisë u mbështet në një sërë faktorësh të cilët me ecurinë e tyre na krijuan bindjen për një relaksim të mëtejshëm të politikës monetare. Sigurisht që nuk mund të lë pa përmendur se në procesin tonë vendimmarrës jemi konsultuar si me faktorët e brendshëm ashtu dhe me konsulentët tanë ndërkombëtarë.

Kuadri i përgjithshëm makroekonomik i vendit i analizuar në të gjitha aspektet e tij përbën një argument të rëndësishëm në mbështetje të këtij vendimi. Më konkretisht, zhvillime të tilla si: ecuria pozitive e treguesve monetarë, pritshmëritë pozitive për to në lidhje me fundin e vitit 2003, mbajtja nën kontroll e deficitit buxhetor, presioni që ushtrojnë mbi kursin e këmbimit normat e interesit në lekë etj., të kombinuara me pritshmëri optimiste në lidhje me ecurinë e inflacionit deri në fund të vitit 2003 (zhvillimet e verifikuara në çmimet e produkteve bujqësore për 3 javët e para të tetorit 2003 rrisnin optimizmin), përbëjnë argumente të qenësishme për justifikimin e këtij veprimi.

Në përfundim, Banka e Shqipërisë e gjykon të përshtatshëm momentin në të cilin është marrë ky vendim pasi ai është në përputhje me statusin juridik të saj, sidomos nga këndvështrimi i pavarësisë së saj. Në përputhje me këtë status dhe me praktikat e njohura ndërkombëtare Banka e Shqipërisë nuk mund të ndërmerrte veprime të tilla në kohë fushatash elektorale ndërkohë që edhe kuptimi mbi pritshmëritë e inflacionit nuk ishte kaq i plotë sa në kohën që po flasim.

FJALA E HAPJES NË SEMINARIN "ZËVENDËSIMI I CASH-IT ME MJETE ALTERNATIVE PAGESE: AVANTAZHET DHE PROBLEMET", TIRANË, 10 NËNTOR 2003

Tashmë që kanë kaluar gati 13 vjet nga fillimi i tranzicionit, sistemi bankar në Shqipëri ka shënuar zhvillime pozitive të rëndësishme në drejtim të parametrave kryesorë si: shtimit të konsiderueshëm të numrit të bankave dhe degëve të tyre, rritjes së numrit dhe cilësisë së shërbimeve bankare, ofrimit të mundësive të përdorimit të mjeteve bashkëkohore të pagesave, uljes së kostos së veprimeve bankare etj., duke ofruar në këtë mënyrë mundësitë reale për zbutjen e veprimeve me lekë në dorë.

Por, ekonomia shqiptare, vazhdon të vuajë problemin shqetësues të qarkullimit të "*cash*"-it ose të parasë në dorë apo jashtë bankave në vlera dhe në përqindje të konsiderueshme, krahasuar me ekonomitë e zhvilluara dhe me ato të rajonit.

Të gjithë aktorët e pranishëm në tryezën e sotme, si institucionet dhe autoritetet publike, komuniteti i biznesit dhe sistemi bankar, gjykoj se ndajmë të njëjtin shqetësim për përmasat e "*cash*"-it në ekonomi dhe çka është më e rëndësishme dëshirën dhe angazhimet për rritjen e qarkullimit të parasë nëpërmjet sistemit bankar.

Tashmë janë hedhur hapat e parë dhe Banka e Shqipërisë e konsideron të suksesshëm faktin që më në fund të gjithë jemi të ndërgjegjësuar për domosdoshmërinë e reduktimit të "*cash*"-it. Media dhe publiku duket se janë partnerët tanë në këtë proces, çka na rrit besimin për zhvillimin e një sistemi pagesash afër standardeve ndërkombëtare dhe evropiane ku kërkojmë të integrohemi.

Është shumë i rëndësishëm fakti që në këtë takim jemi mbledhur të gjithë "regjizorët", pra autoritetet—Banka e Shqipërisë, Ministria e Ekonomisë dhe ajo e Financave, dhe "aktorët" - bankat e nivelit të dytë, biznesi dhe organet fiskale, për kristalizimin e një plani të përbashkët masash të bashkërenduara për të reduktuar "*cash*"-in në ekonomi.

Jam shumë i bindur që të gjithë, përjashtuar shmangësit dhe shkelësit e ligjit, do të jemi përfitues nëse i drejtohemi sporteleve të bankave:

- Banka e Shqipërisë është e interesuar që paraja të kalojë në kanalet bankare në mënyrë që politikat e saj e veçanërisht ajo monetare të jenë më efikase.
- Bankat e nivelit të dytë do të përfitojnë më shumë klientë dhe transaksione, pra më shumë të ardhura dhe fitime të realizuara.
- Biznesi privat, do të përfitonte mbështetjen financiare me kredi dhe konsulencën e bankave të cilat pritet të ulin kostot dhe të rrisnin sigurinë e transaksioneve të ndryshme financiare.
- Organet fiskale, tatimet dhe doganat, sigurisht që do të rrisnin performancën e të ardhurave të siguruara dhe shërbimeve ndaj biznesit nëse tatimpaguesit do t'i drejtoheshin bankave, duke ulur mundësinë e korrupsionit.
- Qeveria do të ishte më efikase në ndërmarrjen e poltikave buxhetore afatmesme për zhvillimin ekonomik të vendit dhe për rritjen ekonomike.
- Publiku, do të përfitonte shërbime më cilësore të pagesave te entet publike, Albtelekom, KESH, Ujësjellës dhe pagesa pagash e pensionesh, në mënyrë më të qytetëruar e bashkëkohore, pa pritur rradhë të gjata e pa humbur kohë në sportele. Dhe çka është më e rëndësishme, klientët do të përfitonin të ardhura nga interesat bankarë dhe lehtësim të procedurave të kreditimit në procesin e vendimmarjes së bankave.

Ndaj, le të hedhim në tryezën e diskutimeve të gjitha argumentet, vërejtjet dhe propozimet konkrete për zgjidhjen e këtij problemi. Në të njëjtën kohë, le të jemi transparentë, të përgjegjshëm, aktivë dhe praktikë në zgjidhjen e pengesave ligjore, administrative dhe logjistike për kalimin e parasë në kanalet bankare.

FJALA NË HAPJEN E FUSHATËS KUNDËR RRITJES SPEKULATIVE TË ÇMIMEVE NË PRAG TË FESTAVE TË FUNDVITIT, 20 NËNTOR 2003

Në prag të festave të fundvitit, të gjithë jemi dëshmitarë të rritjes së çmimeve, që vjen si pasojë e rritjes së kërkesës së përgjithshme. Kjo është ekonomia e tregut mund të mendojë dikush. Kjo është e drejta e secilit për të fituar që, nga ana tjetër, shoqërohet me të drejtën e secilit për të mos u "viktimizuar" nga pozicioni i tij prej njeriu në "nevojë". Si duhet kuptuar kjo? Që të mos blemë fare? Të mos blemë të gjitha që duam? Të mos blemë tek disa tregtarë apo tek disa ofrues të shërbimeve të caktuara? Këto mund të jenë zgjidhje të momentit, për një herë të vetme ose të një personi të veçuar. Ajo që jemi mbledhur të diskutojmë është një zgjidhje që i takon situatës së përgjithshme, të gjithëve ne. Zgjidhje të tilla i ofrojnë institucionet, por duhen mbështetur nga publiku. Që të mbështeten, duhen kuptuar dhe si çdo gjë tjetër që duhet kuptuar, edhe argumenti ynë, duhet më parë të bëhet objekt i një ose më shumë bisedave.

Do të ishte absurde që tregtarët, prodhuesit, biznesmenët ata që ofrojnë shërbime të ndryshme, të mos mendojnë të pasurohen gjithnjë e më shumë. Do të ishte absurde gjithashtu, që një shtresë e caktuar njerëzish të mendojnë se vetëm shteti dhe shoqëria duhet të interesohen për zgjidhjen e problemeve të tyre ekonomike.

Mendoj se është e drejtë të synohet drejt një fitimi të mbështetur në një logjikë të shëndoshë ekonomike, e cila si çdo logjikë tjetër është përpunuar dhe ka kaluar në mjaft përvoja të vendeve të ndryshme. Asgjë që po ndodh sot në vendin tonë, nuk është një fenomen krejtësisht i panjohur. Masa e dëmit që ai shkakton dhe gjurmët që lë në ekonominë e secilit dhe në atë të vendit në përgjithësi, është krejtësisht shqiptare.

TRADITA SHQIPTARE E FESTIMIT

E para, që ka të bëjë me traditën tonë të dikurshme. Me disa përjashtime të vogla në këtë sallë, të gjithë kujtojmë se ç'ndodhte me ne dhe me prindërit tanë në prag të festave të Vitit të Ri. Rradhë të pafundme për të blerë të paktën frutat e stinës, rradhë për të blerë pijet e numëruara në lloje, rradhë edhe në furrat e pjekjes apo për shërbimet e pakta që ofroheshin (ëmbëlsira me porosi në një punishte të vetme pastash që kishte Tirana). Dhe në përfundim të këtij stërmundimi, të gjitha shtëpitë, në mënyrë pak a shumë të njëjtë, kishin të njëjtat rezerva të të njëjtave produkte për disa ditë me rradhë edhe pas Festës. Tregu në përgjithësi mbetej vetëm me zarzavatet e stinës, të cilat ishin prodhimet e vetme të paracionuara. Të ardhur nga një situatë e tillë, me të drejtë të gjithë ne, në momentin e parë, patëm një dëshirë të konsumimit mbi masë. Gjë që shpuri në vazhdimësi të blerjeve me tepricë para festave, në vazhdimësi të grumbullimit të të gjitha blerjeve në të njëjtën kohë e në vazhdimësi të blerjeve të të gjithëve njëkohësisht.

Por, të gjithë harruam se në një ekonomi tregu, për të cilën ne vetë flasim pa pushim, çdo veprim ka pasojën e tij, që në rastin tonë përkthehet në: kërkesë më e rritur do të thotë çmime më të larta. Kështu, secili mund të blejë sa i nevojitet për ditët e festave, se përsëri në treg do të vazhdojë të gjejë të gjitha që i duhen edhe të nesërmen edhe të pasnesermen, edhe të gjitha ditët e tjera. Nga ana tjetër, nuk ka pse çdo artikull të blihet në momentin e fundit. Pijet për shembull, dhe plot produkte të tjera, që mund të rrinë njësoj si në dyqan edhe shtëpi nuk ka pse të mos blihen disa ditë me parë. Vetëm trafikun e ngarkuar që krijohet në rrugët e qytetit, që shpien në tregjet e shumicës apo në pika të tjera të tregtimit të sendeve ushqimore të kujtosh, dhe është e mjaftueshme që mos të të bjerë ndër mend për blerje festash! Kjo është ajo që secili prej nesh ka në dorë të bëjë për të ndihmuar veten dhe të tjerët në këtë rast.

MUNDËSIA PËR TË FESTUAR

E dyta, ka të bëjë me mundësitë për të festuar.

Nga një pyetësor i ditëve të fundit, i bërë nga Banka e Shqipërisë, rezulton se rritja më e madhe e çmimeve vihet re në artikujt ushqimorë dhe në konsumin ushqimor jashtë shtëpisë. Nuk shihet për shembull, e njëjta rritje çmimesh në sendet e çmuara, në ato të kozmetikës, në parfumeri, në biletat e udhëtimit, në artikujt sportivë, në bileta kinemaje, teatri, koncertesh etj.. Shumica e këtyre bizneseve është po aq private dhe e interesuar për fitim sa edhe tregtarët e artikujve ushqimorë, restorantet, hotelet, baret etj.. Po kështu, nuk rriten dhe çmimet e librave, të albumeve, të cilat në botën e sotme të civilizuar shumë shpesh shërbejnë si dhurata simbolike të festave të fundvitit.

SJELLJA E BIZNESIT

Një konkluzion tjetër që ka dalë nga pyetësori me qytetarët e Tiranës, rezulton se spekulimi bëhet nga tregtarët e shumicës. Tani për tani, dua të ndalem në një pikë tjetër që ka të bëjë me mënyrën se si mendon vetë biznesi në lidhje me këtë çështje. Duke iu kthyer arsyetimeve të fillimit të bisedës sonë, dëshiroj të theksoj se edhe pa rritje të qëllimshme çmimesh në pragfesta, përsëri fitohet. Mendoj se asnjerit të pranishëm këtu, nuk i shkon ndër mend që administruesit e bizneseve të tjera, që nuk i rrisin çmimet dhe që ne sapo i përmendëm më sipër, dalin të humbur në këtë sezon "të artë" për të tjerët.

E pra, ja që fitohet edhe pa "spekuluar" të themi me rritjen e kërkesës për produkte të caktuara. Dhe fitohet duke patur një mendim më të qartë ekonomik; duke punuar jo vetëm për momentin por edhe për të ardhmen; duke punuar jo vetëm për fitime materiale, por edhe për një emër të mirë; duke investuar kështu për të ardhmen e biznesit apo të tregtisë.

PO SHTETI Ç'ROL LUAN?

Si çështje të fundit kam menduar të trajtojmë rolin e shtetit dhe ndoshta disa çështje që kanë të bëjnë me edukimin tonë. Të gjithë ishim mësuar që shteti të kontrollonte rregullimin e përgjithshëm të tregut në masën që ai mundej. Se sa ky rregullim përputhej me kërkesën tonë dhe sa e plotësonte atë, tashmë është një argument tejet i konsumuar për të cilin nuk ia vlen të shpenzohen minutat e këtij takimi. Në momentin që flasim, shteti ka po ashtu një sërë detyrimesh të cilat, për të qenë të sinqertë, nuk është se gjithmonë i ka përmbushur maksimalisht. Kjo për shumë arsye, të cilat gjithashtu, nuk janë qëllim i këtij takimi.

Pavarësisht sa më sipër, që shteti të realizojë rolin e tij klasik në një ekonomi tregu, përveç të tjerash i duhet në një masë jo të vogël bashkëpunimi i të gjithëve ne. Që ky bashkëpunim të funksionojë në të gjitha hallkat – tregtarë – biznes – prodhues – konsumatorë – duhet që secili të ketë të qartë, se të jetuarit në komunitet ka detyrimet e veta të pashkruara, të cilat, në një masë të caktuar, nuk mund t'i imponojë asnjë shtet. Derisa të gjithë së bashku, kemi marrë përsipër të jetojmë në një ekonomi tregu dhe të ndërtojmë një shoqëri të ekonomisë së përparuar duhet që, gjithashtu së bashku të pranojmë pjesën tonë të "fajit" në vështirësitë që i kemi shkaktuar njeri-tjetrit dhe të respektojmë ndershmërisht rregullat e lojës.

FJALA NË KOMITETIN NDËRMINISTRON TË POLITIKAVE TË SIGURIMIT KOMBËTAR, 24 NËNTOR 2003

Ekonomia shqiptare gjatë vitit 2003 duket se i është kthyer ritmeve të rritjes së saj potenciale, pas ngadalësimit të vërejtur në vitin 2002. Tregues të ndryshëm përgjithësisht nxjerrin në pah se parashikimi i rritjes ekonomike për vitin 2003, rreth 6 për qind, mbetet një mundësi realiste. Zhvillime të tilla si: qëndrueshmëria në prodhimin bujqësor, performanca optimiste në degët e shërbimeve, të industrisë dhe të transportit, rritja e vëllimit të shkëmbimit tregtar e verifikuar në gjashtëmujorin e parë të vitit, numri i shtuar i turistëve, situata e qëndrueshme dhe e favorshme energjitike, qëndrueshmëria në prurjet valutore të emigrantëve e faktorë të tjerë, janë argumente të besueshme në arritjen e objektivit të rritjes ekonomike të vendit.

Viti 2003 vlerësohet se do të shënojë një vit tjetër me stabilitet të çmimeve të konsumit. Ashtu si dhe gjatë 3 – 4 vitet të mëparshme, parashikimet e Bankës së Shqipërisë flasin për një normë vjetore inflacioni brenda intervalit objektiv, 2 – 4 për qind. Sipas të dhënave më të fundit, në përfundim të muajit tetor 2003, ndryshimi dymbëdhjetëmujor i indeksit të çmimeve të konsumit regjistroi shifrën 2.9 për qind, ndërkohë që inflacioni vjetor i matur si mesatare e dymbëdhjetë muajve të fundit shënoi vetëm 2.27 për qind, duke përforcuar një tendencë të qartë rënëse të tij.

Banka e Shqipërisë, në analizat e saj të kohëve të fundit, ka nënvizuar se politika monetare e ndjekur prej saj ka marrë jetë në kushtet e një politike fiskale të kujdesshme, ku theks i veçantë i është vënë kontrollit të shpenzimeve buxhetore në raport me të ardhurat e realizuara. Kjo ka bërë që deri në këtë moment nevojat për likuiditet të qeverisë të përballohen plotësisht nga ana e sistemit bankar, duke e bërë të panevojshëm financimin e Bankës së Shqipërisë. Në këto rrethana presionet fiskale mbi politikën monetare janë të zbehta. Duke vijuar këtë rrjedhë arsyetimi, mund të konkludohet se lëvizja e të dyja politikave (asaj monetare dhe asaj fiskale) ka qenë e harmonizuar dhe në përputhje me programin e përgjithshëm të zhvillimit ekonomiko – financiar të vendit. Financimi i brendshëm i deficitit buxhetor nga sistemi bankar gjatë vitit 2003 është parashikuar të jetë afërsisht në të njëjtin nivel me atë të vitit 2002, duke qenë rreth 2.2 për qind e PBB-së. Niveli i qëndrueshëm i huamarrjes së brendshme të qeverisë, përballë rritjes së shpejtë të depozitave në lekë, ka qenë një tjetër faktor që ka ndikuar në rënien e shpejtë të interesave të bonove të thesarit.

Politika monetare e vitit 2003 ka vazhduar të jetë e kujdesshme, me tendenca zbutjeje. Kjo është pasqyruar në uljen e normave të interesit tre herë gjatë këtij viti. Duke ndjekur në vazhdimësi ecurinë e inflacionit dhe treguesit e likuiditetit të sistemit bankar, Banka e Shqipërisë ka ulur me 1.5 pikë përqindjeje në total normën e marrëveshjeve të riblerjes gjatë vitit 2003, duke e çuar atë në fund të muajit tetor në nivel të njëjtë me nivelin e parakrizës së likuiditetit të vitit të kaluar.

Sistemi bankar ka reaguar duke ulur normat e interesit të pranimit të depozitave, të bonove të thesarit dhe të transaksioneve në tregun ndërbankar. Pritjet e ulta inflacioniste të bankave kanë bërë që reagimi i sistemit bankar në uljen e normës së interesit të tejkalojë uljen e normës bazë të interesit në afatin e maturimit tremujor, si për depozitat ashtu dhe për bonot e thesarit. Kjo ka ndikuar në uljen e normave reale të interesit gjatë vitit 2003. Gjithsesi, ato kanë mbetur pozitive në sajë të ruajtjes së normës së inflacionit brenda objektivit të Bankës së Shqipërisë në gjashtë muajt e fundit. Normat reale të interesit në terma pozitivë kanë ruajtur interesin e individëve dhe të subjekteve për të depozituar kursimet e tyre në sistemin bankar, duke ndihmuar kështu në ruajtjen e raporteve të likuiditetit në sistem. Zhvillimet monetare tregojnë se hemoragjia e depozitave në pranverën e vitit 2002, është tejkaluar plotësisht, gjë që manifestohet në një tepricë likuiditeti të sistemit bankar, e cila mesatarisht është luhatur

në nivelin 5.3 miliardë lekë gjatë vitit 2003. Vlen të theksohet se krijimi i likuiditetit të tepërt ka ndikuar në uljen e kostos së ndërmjetësimit të sistemit bankar, i shprehur në uljen e diferencës së normave të interesit të bonove të thesarit dhe të depozitave në lekë. Në mbështetje të rritjes së ekonomisë, duket se viti në vazhdim ka shënuar një rritje të mbështetjes së ekonomisë me kredi. Portofoli i kredisë së bankave për sektorin privat të ekonomisë është rritur me 9.3 miliardë lekë gjatë 9 muajve të parë të vitit. Gjatë kësaj periudhe ekonomisë i janë dhënë 63.8 miliardë lekë kredi e re ose 44 për qind më shumë se gjatë së njëjtës periudhë të vitit të kaluar.

Bazuar në zhvillimet e verifikuara gjatë nëntëmujorit, në zhvillimet aktuale në likuiditetin e sistemit bankar etj., mund të konkludohet se zhvillimet monetare gjatë vitit 2003, do të jenë një kontribut më shumë në konsolidimin e ekuilibrit të përgjithshëm makroekonomik të vendit.

Nga ana tjetër, zhvillimet në sektorin e jashtëm të ekonomisë flasin për një rritje të mëtejshme të aktivitetit të tregtisë së jashtme ku zhvillimet më pozitive i përkasin rritjes së eksporteve dhe dërgesave nga emigrantët. Ndërkohë, sipas të dhënave paraprake numri i turistëve në 9 muajt e parë të vitit 2003 ka njohur rritje, duke regjistruar kështu një tjetër zhvillim optimist. Kursi i këmbimit, duke pasqyruar zhvillimet në përqindjet e interesit në ekonominë amerikane dhe në atë evropiane, zhvillimet në tregjet ndërkombëtare si dhe ato në tregun e brendshëm, leku ka manifestuar një lloj mbiçmimi ndaj dy monedhave kryesore. Në këto rrethana, Banka e Shqipërisë herë pas here ka ndërhyrë në treg për të zbutur presionet e ofertës në valutë. Si rrjedhojë, rezervat valutore të Bankës së Shqipërisë, në vlerë absolute, në fund të muajit shtator, regjistruan nivelin 965 milionë dollarë amerikanë, nivel ky që korrespondon me objektivin e Bankës së Shqipërisë për të mbuluar 4.5 muaj importe.

Për një perceptim më të plotë në lidhje me situatën e pritur ekonomike për fundin e vitit 2003, në vijim jepet një tabelë me treguesit e përgjithshëm të zhvillimit ekonomik të vendit, përfshirë dhe ata monetarë.

Banka e Shqipërisë shpreson se për pjesën e mbetur të vitit nuk do të ketë ndonjë zhvillim surprizë i cili do të dëmtonte përpjekjet e bëra gjatë vitit 2003.

Tabelë 1: Tregues të përgjithshëm ekonomikë.

	1996	1997	1998	1999	2000	2001	2002	2003*
Rritja reale e PBB-së (në %)	9.1	-10.3	12.7	8.9	7.7	6.8	4.7	6.0
Numri i të punësuarve (në mijë)	1,116	1,107	1,085	1,065	1,068	920.5	920	927
Përqindja e papunësisë	12.4	14.9	17.8	18.2	16.8	16.4	15.8	15.2
Përqindja e inflacionit (v/v)	17.4	42.1	8.7	-1	4.2	3.5	2.1	3.0
Rritja e agregatit M3	44	28	21	22	12	20	6	9.5
Shpejtësia e M3	1.82	1.72	1.92	1.73	1.64	1.51	1.58	1.66
Rritja e PjB	14	52	-6	19	22	20	10	-3.3
Kredia e re për ekonominë (mld lekë)	7.4	3.98	5.8	8	24	40.6	62.6	63.8
Depozitat në lekë (milionë lekë)	72,831	89,495	130,940	158,326	165,261	186,211	193,886	223,500
Deficiti i buxhetit (në % të PBB-së)	-11.4	-13.2	-11.3	-11.9	-9.1	-8.3	-6.2	-4.6
Borxhi i brendshëm (në % të PBB-së)	30.7	36.18	35.12	36.31	41.01	39.42	38.49	39.1
Llogaria korente (në % të PBB-së)1/	-11.5	-12.03	-6.12	-7.34	-7.1	-6.1	-8.9	-8.5
Borxhi i jashtëm (në % të PBB-së)	29.2	33.2	31.8	29.1	30.2	28.2	24.9	23.7
Kursi mesatar i këmbimit lek/usd	104.5	148.9	150.6	137.7	143.7	143.48	140.15	123.8**
Kursi mesatar i këmbimit lek/euro				146.9	132.58	128.5	132.4	138.2**

Shënim: * llogaritja e PBB është nga INSTAT me metodologji të ndryshuar, vetëm për vitet 1996-2000.
** mesatarja e vitit 2003 deri në muajin tetor 2003.
* pothuajse të gjitha të dhënat e vitit 2003 janë parashikime.
Burimi : INSTAT , Ministria e Financave , Banka e Shqipërisë dhe vlerësime të FMN-së.

FJALA NË KOMISIONIN PARLAMENTAR TË EKONOMISË, FINANCAVE DHE PRIVATIZIMIT NË KUVENDIN E SHQIPËRISË, 15 DHJETOR 2003

PROGRAMI MONETAR I VITIT 2004, BASHKËJETESA E TIJ ME POLITIKËN FISKALE.

VITI 2003 NË SHIFRA

Ekonomia shqiptare gjatë vitit 2003 duket se i është kthyer ritmeve të rritjes së saj potenciale, pas ngadalësimit të vërejtur në vitin 2002. Tregues të ndryshëm përgjithësisht nxjerrin në pah se parashikimi i rritjes ekonomike për vitin 2003, rreth 6 për qind, mbetet një mundësi realiste. Zhvillime të tilla si: qëndrueshmëria në prodhimin bujqësor, performanca optimiste në degët e shërbimeve, të industrisë dhe të transportit, rritja e vëllimit të shkëmbimit tregtar e verifikuar në gjashtëmujorin e parë të vitit, numri i shtuar i turistëve, situata e qëndrueshme dhe e favorshme energjitike, qëndrueshmëria në prurjet valutore të emigrantëve e faktorë të tjerë, janë argumente të besueshme në arritjen e objektivit të rritjes ekonomike të vendit.

Viti 2003 vlerësohet se do të shënojë një vit tjetër me stabilitet të çmimeve të konsumit. Ashtu si dhe gjatë 3 – 4 vitet të mëparshme, parashikimet e Bankës së Shqipërisë flasin për një normë vjetore inflacioni brenda intervalit objektiv, 2 – 4 për qind. Sipas të dhënave më të fundit, në përfundim të muajit nëntor 2003, ndryshimi dymbëdhjetëmujor i indeksit të çmimeve të konsumit regjistroi shifrën 3.4 për qind, ndërkohë që inflacioni vjetor i matur si mesatare e dymbëdhjetë muajve të fundit shënoi vetëm 2.24 për qind, duke përforcuar një tendencë të qartë rënëse të tij.

Banka e Shqipërisë, në analizat e saj të kohëve të fundit, ka nënvizuar se politika monetare e ndjekur prej saj ka marrë jetë në kushtet e një politike të kujdesshme financiare buxhetore, ku theks i veçantë i është vënë kontrollit të shpenzimeve buxhetore në raport me të ardhurat e realizuara. Kjo ka bërë që deri në këtë moment nevojat për likuiditet të qeverisë të përballohen plotësisht nga ana e sistemit bankar, duke e bërë të panevojshëm financimin e Bankës së Shqipërisë. Në këto rrethana presionet fiskale mbi politikën monetare janë të zbehta. Duke vijuar këtë rrjedhë arsyetimi, mund të konkludohet se lëvizja e të dy politikave (asaj monetare dhe asaj fiskale) ka qenë e harmonizuar dhe në përputhje me programin e përgjithshëm të zhvillimit ekonomiko – financiar të vendit.

Financimi i brendshëm i deficitit buxhetor nga sistemi bankar gjatë vitit 2003 është parashikuar të jetë afërsisht në të njëjtin nivel me atë të vitit 2002, duke qenë rreth 2.2 për qind e PBB-së. Niveli i qëndrueshëm i huamarrjes së brendshme të qeverisë, përballë rritjes së shpejtë të depozitave në lekë, ka qenë një tjetër faktor që ka ndikuar në rënien e shpejtë të interesave të bonove të thesarit. Politika monetare e vitit 2003 ka vazhduar të jetë e kujdesshme, me tendenca zbutjeje. Kjo është pasqyruar në uljen e normave të interesit tre herë gjatë këtij viti. Duke ndjekur në vazhdimësi ecurinë e inflacionit dhe treguesit e likuiditetit të sistemit bankar, Banka e Shqipërisë ka ulur me 1.5 pikë përqindjeje në total normën e marrëveshjeve të riblerjes gjatë vitit 2003, duke e çuar atë në fund të muajit tetor në nivel të njëjtë me nivelin e parakrizës së likuiditetit të vitit të kaluar.

Sistemi bankar ka reaguar duke ulur normat e interesit të pranimit të depozitave, të bonove të thesarit dhe të transaksioneve në tregun ndërbankar. Pritjet e ulta inflacioniste të bankave kanë bërë që reagimi i sistemit bankar në uljen e normës së interesit të tejkalojë uljen e normës bazë të interesit në afatin e maturimit tremujor, si për depozitat ashtu dhe për bonot e thesarit. Kjo ka ndikuar në uljen e normave reale të interesit gjatë vitit 2003. Gjithsesi, ato kanë mbetur pozitive në sajë të ruajtjes së normës së inflacionit brenda objektivit të Bankës së Shqipërisë në gjashtë muajt e fundit. Normat reale të interesit në terma pozitivë kanë ruajtur interesin e individëve dhe të subjekteve për të

depozituar kursimet e tyre në sistemin bankar, duke ndihmuar kështu në ruajtjen e raporteve të likuiditetit në sistem. Zhvillimet monetare tregojnë se hemoragjia e depozitave në pranverën e vitit 2002, është tejkaluar plotësisht, gjë që manifestohet në një tepricë likuiditeti të sistemit bankar, e cila mesatarisht është luhatur në nivelin 5.3 miliardë lekë gjatë vitit 2003. Vlen të theksohet se krijimi i likuiditetit të tepërt ka ndikuar në uljen e kostos së ndërmjetësimit të sistemit bankar, i shprehur në uljen e diferencës së normave të interesit të bonove të thesarit dhe të depozitave në lekë.

Gjithashtu, duke u nisur nga tendencat mbiçmuese të lekut gjatë vitit 2003, Banka e Shqipërisë ka qenë e pranishme në tregun valutor, me kah neto atë të blerjes. Aktiviteti valutor i Bankës së Shqipërisë ka rezultuar në injektimin e 3.9 miliardë lekëve likuiditet në treg. Gjithsesi, duke u nisur nga ecuria e likuiditetit të tepërt të bankave, Banka e Shqipërisë ka sterilizuar efektin e blerjes së valutës. Ajo ka shitur me të drejta të plota bono thesari nga portofoli i saj, me vlerë 4.07 miliardë lekë. Pjesa tjetër e likuiditetit të tepërt është tërhequr nëpërmjet marrëveshjeve të riblerjes.

Në mbështetje të rritjes së ekonomisë, duket se viti në vazhdim ka shënuar një rritje të mbështetjes së ekonomisë me kredi. Portofoli i kredisë së bankave për sektorin privat të ekonomisë është rritur me 10.1 miliardë lekë gjatë 10 muajve të parë të vitit. Gjatë kësaj periudhe ekonomisë i janë dhënë 70.6 miliardë lekë kredi e re (rreth 660 milionë usd) ose 45 për qind më shumë se gjatë së njëjtës periudhë të vitit të kaluar.

Bazuar në zhvillimet e verifikuara gjatë dhjetëmujorit, në zhvillimet aktuale në likuiditetin e sistemit bankar etj., mund të konkludohet se zhvillimet monetare gjatë vitit 2003, do të jenë një kontribut më shumë në konsolidimin e ekuilibrit të përgjithshëm makroekonomik të vendit. Gjithësesi për një perceptim më të plotë në lidhje me situatën e pritur ekonomike për fundin e vitit 2003, në vijim jepet një tabelë me treguesit e përgjithshëm të zhvillimit ekonomik të vendit, përfshirë dhe ata monetarë.

Tabelë 1: Tregues të përgjithshëm ekonomikë.

	1996	1997	1998	1999	2000	2001	2002	2003*
Rritja reale e PBB-së (në %)	9.1	-10.3	12.7	8.9	7.7	6.8	4.7	6.0
Numri i të punësuarve (në mijë)	1,116	1,107	1,085	1,065	1,068	920.5	920	927
Përqindja e papunësisë	12.4	14.9	17.8	18.2	16.8	16.4	15.8	15.2
Përqindja e inflacionit (v/v)	17.4	42.1	8.7	-1	4.2	3.5	2.1	3.0
Rritja e agregatit M3	44	28	21	22	12	20	6	9.5
Shpejtësia e M3	1.82	1.72	1.92	1.73	1.64	1.51	1.58	1.66
Rritja e PjB	14	52	-6	19	22	20	10	-3.3
Kredia e re per ekonominë (mld lekë)	7.4	3.98	5.8	8	24	40.6	62.6	70.6
Depozitat në lekë (milionë lekë)	72,831	89,495	130,940	158,326	165,261	186,211	193,886	223,500
Deficiti i buxhetit (në % të PBB-së)	-11.4	-13.2	-11.3	-11.9	-9.1	-8.3	-6.2	-4.6
Borxhi i brendshëm (në % të PBB-së)	30.7	36.18	35.12	36.31	41.01	39.42	38.49	39.1
Llogaria korente (në % të PBB-së)1/	-11.5	-12.03	-6.12	-7.34	-7.1	-6.1	-8.9	-8.5
Borxhi i jashtëm (në % të PBB-së)	29.2	33.2	31.8	29.1	30.2	28.2	24.9	23.7
Kursi mesatar i këmbimit lek/usd	104.5	148.9	150.6	137.7	143.7	143.48	140.15	123.1**
Kursi mesatar i këmbimit lek/euro				146.9	132.58	128.5	132.4	137.9**

Shënim: * llogaritja e PBB eshte nga INSTAT me metodologji të ndryshuar, vetëm për vitet 1996 - 2000.
** mesatarja e vitit 2003 deri në muajin nëntor 2003.
* pothuajse të gjitha të dhënat e vitit 2003 janë parashikime.
Burimi : INSTAT , Ministria e Financave , Banka e Shqipërisë dhe vlerësime të FMN-së.

Si konkluzion, do të desha të ritheksoja edhe një herë rëndësinë e kuptimit nga ana e publikut të faktit se Banka e Shqipërisë nuk i merr vendimet e saj politike në mënyrë të shkëputur, por duke ndjekur ngushtë të gjitha zhvillimet ekonomike. Ashtu siç është bërë tashmë traditë, politika monetare e Bankës së Shqipërisë është pjesë përbërëse e programit të përgjithshëm të zhvillimit ekonomik të vendit. Si e tillë, ajo nuk mund të jetë gjë tjetër veçse një tërësi vendimesh dhe masash të cilat, në harmoni me politikat e tjera, atë fiskalë, etj., synojnë rritjen ekonomike dhe uljen e varfërisë në vend. Bashkërendimi i politikave monetare dhe fiskale arrihet në programin afatmesëm të zhvillimit të vendit, i cili mbulon një periudhë trevjeçare. Logjika e përgjithshme e këtij programi, i jep një rëndësi parësore ruajtjes së stabilitetit makroekonomik. Ruajtja e stabilitetit makroekonomik shërben si pikë lidhëse midis politikës monetare dhe fiskale. Në zbërthim të ruajtjes së këtij stabiliteti, politika monetare angazhohet në ruajtjen e stabilitetit të çmimeve ndërsa ajo fiskale në kontrollin e deficitit buxhetor. Këta tregues makroekonomikë kanë lidhje të ngushtë me njëri-tjetrin: përmbushja e secilit prej tyre parasheh si kusht thelbësor respektimin e objektivit tjetër. Në vijim të kësaj ideje dhe për ta mbështetur atë me shifra, më lejoni të hedh për pak një vështrim në të kaluarën.

Shëndoshja e Shtetit Shqiptar gjatë viteve të fundit, rritja ekonomike dhe përmirësimi i punës së organeve tatimore dhe doganore, kanë bërë të mundur uljen e deficitit buxhetor. Ky deficit ka zbritur nga 11.4 për qind e PBB-së në vitin 1998, në 6.9 për qind të PBB-së në vitin 2002. Në vitin 2003 ai parashikohet të ulet në nivelin 5.8 për qind të PBB-së ndërsa projektbuxheti i vitit 2004 ka një objektiv edhe më ambicioz: uljen e deficitit të përgjithshëm buxhetor në nivelin 4.8 për qind të PBB-së. Kjo disiplinë fiskale ka dhënë frutet e veta. Ajo ka ndikuar në uljen e normave të interesit të bonove të thesarit, duke sjellë një ulje tërësore të normave të interesit në ekonomi. Ulja e normave të interesit dhe ulja e kërkesës së qeverisë për fonde, i ka dhënë më shumë frymëmarrje kreditimit të ekonomisë. Ajo ka çliruar më shumë fonde, me një normë interesi më të ulët, për t'u përdorur në mbështetje të sektorit privat. Sipas të dhënave të Bankës së Shqipërisë, kreditimi i ekonomisë është rritur mesatarisht me 90 për qind në vit gjatë periudhës 1999-2002. Nga ana tjetër, ulja e financimit të Bankës së Shqipërisë për buxhetin e shtetit, ka dhënë efekte pozitive në treguesit e likuiditetit në sistem. Zhvendosja e strukturës kohore të mjeteve monetare drejt atyre afatgjata ka kontribuar direkt në ruajtjen e inflacionit në nivele të ulta. Inflacioni është ulur nga 8.7 për qind në vitin 1998 në 2.1 për qind në vitin 2002. Gjatë tre viteve të fundit ai ka qenë brenda objektivit 2 - 4 për qind të Bankës së Shqipërisë.

PROGRAMI MONETAR I VITIT 2004.

Në përputhje me kuadrin e saj të hartimit dhe të zbatimit të politikës monetare, Banka e Shqipërisë ndërton çdo vit programin monetar, i cili është një plan financiar që synon disiplinimin e qarkullimit të fondeve në ekonomi, në përputhje me objektivat e zhvillimit të vendit. Synimi kryesor është përmbushja e nevojave të ekonomisë për mjete monetare, pa ndikuar në prishjen e ekuilibrit të kërkesës dhe ofertës për mjete monetare, duke prodhuar inflacion ose duke kontraktuar ekonominë.

Edhe programi monetar i vitit 2004 është ndërtuar mbi të njëjtat premisa. Nuk përbën ndonjë sekret fakti që edhe për vitin e ardhshëm, ashtu si në vitet e mëparshme, dy institucionet kryesore vendimmarrëse të vendit në fushën e ekonomisë dhe të financave, Qeveria e Shqipërisë dhe Banka e Shqipërisë, kanë arritur konsensusin për objektivat e përgjithshëm të zhvillimit të vendit, përfshirë dhe atë që konsiderohet si bashkëjetesë e harmonizuar midis politikave fiskale dhe monetare. Për më tepër, ky proces ka qenë pjesë e një konsultimi konstruktiv me institucione të tilla si Fondi Monetar Ndërkombëtar dhe Banka Botërore, duke bërë të mundur që edhe për vitin 2004 të arrihet një marrëveshje e re financiare me këto dy institucione.

Tabelë 2. Treguesit kryesorë makroekonomikë*.

	2000	2001	2002	2003	2004
Treguesit e ekonomisë reale (në pikë përqindjeje)					
Rritja PBB	7.8	6.5	4.5 - 5	6.0	6.0
IÇK vjetor (mesatar)	0.0	3.1	5.2	2.3	3.0
PBB nominale (miliardë lekë)	539.2	590.2	678	745	823
Treguesit fiskalë (në përqindje ndaj PBB)					
Deficiti fiskal	-8.9	-8.2	-6.9	-5.8	-4.8
Treguesit monetarë (në pikë përqindjeje)					
Rritja M3	12	19.9	7.0	9.5	10.6
Normat e interesit të BTh 3m	7.8	8.0	10.6	7.6	

* Parashikimet e sektorit të jashtëm janë të muajit qershor 2003.

INFLACIONI DHE POLITIKA MONETARE GJATË VITIT 2004.

Politika monetare e Bankës së Shqipërisë gjatë vitit 2003 është karakterizuar nga tendencat lehtësuese të kushteve monetare, në përputhje me zbutjen e presioneve inflacioniste dhe me përmirësimin e treguesve monetarë. Banka e Shqipërisë ka filluar zbatimin e një politike monetare zbutëse që prej muajit prill të këtij viti, duke ulur normën bazë të interesi me 0.5 pikë për qind. Në muajt korrik dhe tetor të këtij viti u bënë dhe dy ulje të tjera, 0.5 pikë përqindje secila, duke e çuar normën bazë të interesit në nivelin që kishte në fillim të një viti më parë. Në fund të muajit nëntor të vitit 2003, norma bazë e interesit ishte 7.0 për qind, norma vjetore e inflacionit për këtë muaj rezultoi 3.4 për qind, ndërsa inflacioni mesatar vjetor në fund të muajit tetor është vetëm 2.24 për qind.

Gjithashtu, Banka e Shqipërisë ka qenë e pranishme në tregun valutor gjatë vitit 2003, duke blerë valutë. Aktiviteti valutor i Bankës së Shqipërisë ka ndihmuar në injektimin e likuiditetit në treg dhe ka zbutur tendencat mbiçmuese të lekut gjatë këtij viti.

Parashikimet e tendencave kryesore të treguesve monetarë dhe të inflacionit për vitin 2004, sugjerojnë se Banka e Shqipërisë duhet të ndjekë një politikë të ngjashme edhe gjatë vitit 2004. Zhvillimet në çmimet e konsumit karakterizohen nga presione të ulëta inflacioniste. Parashikimet tona tregojnë se objektivi i Bankës së Shqipërisë për inflacionin do të përmbushet gjatë vitit 2003. Në mungesë të fenomeneve *shock*, inflacioni duket se do të jetë brenda kontrollit edhe për vitin 2004. Gjithashtu, pritjet e ekonomisë duket se flasin për një qëndrueshmëri në nivelin aktual të inflacionit. Raportet dhe struktura e likuiditetit në ekonomi duket se janë afër niveleve të tyre historike, ndërsa normat e interesit kanë patur tendencë rënëse gjatë vitit 2003. Në këto kushte, Banka e Shqipërisë, në varësi të ecurisë së mëtejshme të treguesve monetarë dhe atyre të inflacionit, mund të shikojë mundësinë e një uljeje të mëtejshme të normave të interesit, në mbështetje të aktivitetit ekonomik ose të objektivit të inflacionit. Duke përgjithësuar analizën e tendencave aktuale, mund të themi se gjatë vitit 2004 normat e interesit do të jenë përgjithësisht të qëndrueshme ose me tendencë rënëse.

Analiza e treguesve monetarë për vitin 2004 tregon se Banka e Shqipërisë, me sa duket, duhet të jetë përsëri e pranishme në tregun valutor, për të penguar një mbiçmim të mëtejshëm të lekut. Duke analizuar zhvillimet e treguesve monetarë gjatë viteve të fundit, vëmë re se oferta e lekut (rritja e M2) në tregun e brendshëm ka qenë në rënie, si pasojë e mungesës së të ardhurave të privatizimit të qeverisë, të cilat Banka e Shqipërisë i ka konvertuar në lekë duke hedhur likuiditet në treg. Oferta e reduktuar e lekut, së bashku me kërkesën e rritur për të (si pasojë normave të larta të interesit të aseteve financiare në lekë gjatë vitit 2003), kanë ushtruar presion për mbiçmimin e lekut gjatë vitit 2003.

SUPOZIMET KRYESORE TË PROGRAMIT MONETAR TË BANKËS SË SHQIPËRISË PËR VITIN 2004.

Në hartimin e programit monetar për vitin 2004 është mbajtur parasysh përmbushja e objektivit të Bankës së Shqipërisë, ruajtja e normës vjetore të inflacionit brenda kufijve 2 - 4 për qind.

Në funksion të këtij objektivi, programi monetar synon kontrollin e rritjes së ofertës monetare në mënyrë që niveli i mjeteve monetare reale t'i përgjigjet nevojave reale të ekonomisë për një rritje ekonomike prej 6 për qind. Parashikimi i kërkesës së ekonomisë vazhdon të mbështetet në parashikimin e shpejtësisë thuajse konstante të qarkullimit të parasë. Ky parashikim, duke u nisur nga niveli i PBB-së nominale, është pika lidhëse midis inflacionit dhe rritjes së ofertës monetare (objektivi i ndërmjetëm).

- Inflacioni është parashikuar të jetë brenda objektivit të Bankës së Shqipërisë.
- Normat e interesit parashikohen të jenë të qëndrueshme ose me tendencë rënëse.
- Kërkesa e qeverisë, e cila përbën burimin kryesor të kërkimit të fondeve, parashikohet të jetë në të njëjtin nivel, 2.7 për qind të PBB-së.
- Ritmi i rritjes së kërkesës për ekonominë parashikohet të jetë afërsisht i njëjtë me atë të vitit 2003.

Bazuar në këto konsiderata, shpejtësia e qarkullimit të M3 sipas tremujorëve është si më poshtë:

Tabelë 3. Shpejtësia e qarkullimit të parasë në 2004. (PBB tremujore*100 / M3)

Dhje '02	Mars	Qershor	Shtator	Dhje '03	Mars	Qershor	Shtator	Dhje '04
42.9	43.9	43.9	42.9	42.9	44.1	43.3	43.2	43.1

Programi monetar garanton respektimin e objektivave sasiorë të Bankës së Shqipërisë, mbajtjen e nivelit të MBN dhe RNN të Bankës së Shqipërisë brenda kufijve dhe kontrollin e huamarrjes së brendshme të qeverisë në nivelin 2.7 për qind të PBB-së.

OFERTA MONETARE DHE PËRBËRËSIT E SAJ.

Shpejtësia e parasë parashikohet të jetë relativisht e qëndrueshme gjatë vitit 2004. Ky supozim mbështetet në ruajtjen e tendencave të zhvillimeve monetare të vitit 2003 edhe për vitin 2004. Kështu:

Bazuar në këtë parashikim, oferta monetare parashikohet të rritet me 10.6 për qind ose 47.4 miliardë lekë.

PËRBËRJA E OFERTËS MONETARE.

Raporti i parasë jashtë bankave ndaj ofertës monetare i vërejtur gjatë vitit 2003 nuk pritet të pësojë ndryshime thelbësore gjatë vitit të ardhshëm. Ndërkohë që parashikohet një tendencë në rritje e raportit të depozitave në valutë ndaj M3, duke sjellë një rënie të peshës së depozitave në lekë ndaj ofertës monetare. Depozitat në valutë pritet të kenë një rritje të konsiderueshme vjetore, prej rreth 18.2 për qind ose 17.7 miliardë lekë, në fund të vitit 2004.

Tabelë 4. Rritja e ofertës monetare sipas tremujorëve (në miliardë lekë).

	T1	T2	T3	T4	2004
Oferta monetare	10.9	11.0	11.5	14.0	47.4
Paraja jashtë bankave	1.7	3.1	3.2	6.9	14.9
Depozita në lekë	4.1	3.6	3.7	3.4	14.8
Depozita në valutë	5.1	4.3	4.5	3.7	17.7

Në përgjithësi, rritja e agregatit M2 do të ndjekë ecurinë e kërkesës së ekonomisë për mjete monetare. Kjo kërkesë pritet të jetë më e lartë në tremujorin e parë të vitit të ardhshëm.

Tabelë 5. Rritja e M2 dhe e kërkesës për mjete monetare në lekë (në miliardë lekë).

	T1	T2	T3	T4	2003
Financimi i deficitit	7.2	4.2	3.6	5.0	20.0
Kredia për ekonominë në lekë	0.5	0.5	0.5	0.5	2.0
Rritja e rezervës valutore	0	1.8	2.4	1.2	5.4
Shuma	7.7	6.5	6.5	6.7	27.4
Rritja M2	5.8	6.7	7.0	10.2	29.7

Arritja e ekuilibrave të treguesve monetarë dhe ulja e normës bazë të interesit në nivelet që kishte në fillim të vitit 2002, pritet të lejojnë rritjen normale të agregatit M1. Depozitat pa afat në lekë parashikohen lehtësisht më të larta vitin e ardhshëm. Megjithatë, ndikimin kryesor në rritjen e agregatit M1 do ta ketë rritja e parasë jashtë bankave. Paraja jashtë bankave parashikohet të rritet me rreth 14.9 miliardë lekë gjatë vitit të ardhshëm. Raporti i parasë jashtë bankave ndaj ofertës monetare supozohet të luhatet rreth nivelit 28.0 për qind. Një parashikim i tillë mbështetet në faktin se ky raport është shfaqur përgjithësisht si një nivel ekuilibri në ekonominë shqiptare. Gjithashtu, parashikimi për një qëndrueshmëri (ose ulje) të normave të interesit e mbështet më tepër këtë supozim. Gjithsesi, duke u nisur nga tendenca historike, ky raport pritet të ketë tendencë rritëse në tremujorin e fundit të vitit.

Ecuria e parasë jashtë bankave sipas parashikimeve të programit monetar, do të bëjë të mundur edhe respektimin e objektivit të MBN të Bankës së Shqipërisë. Duke supozuar se ecuria e RNN të Bankës së Shqipërisë do të jetë sipas programit, realizimi i parashikuar i objektivit të MBN do të jetë si më poshtë:

privat për mjete monetare në lekë parashikohet 14.5 miliardë lekë. Kjo do të mundësojë që sistemi bankar të ruajë një gjendje të qëndrueshme likuiditeti gjatë vitit 2004.

Sistemi bankar parashikohet të plotësojë totalisht nevojat e sektorit privat për kredi në lekë si dhe kërkesën e qeverisë për financimin e deficitit në masën 62.5 për qind të financimit total prej 20.0 miliardë lekësh. Banka e Shqipërisë mund të financojë deri në 5 për qind të mesatares së të ardhurave të qeverisë në tre vitet e fundit ose rreth 7.5 miliardë lekë. Në këtë mënyrë, huamarrja ose investimi i fondeve të lira të bankave të nivelit të dytë në Bankën e Shqipërisë do të shërbejë për zbutjen e efekteve të disbalancimit të kërkesës dhe ofertës për mjete monetare të brendshme në ecurinë e likuiditetit gjatë vitit.

KËRKESA E EKONOMISË PËR MJETE MONETARE

POZICIONI VALUTOR I SISTEMIT BANKAR

Mjetet valutore neto të sistemit bankar për vitin e ardhshëm parashikohet të rriten me rreth 8.6 miliardë lekë ose 5.1 për qind nga viti kaluar.

Tabelë 6. Objektivi i Mjeteve të Brendshme Neto (në miliardë lekë).

	Dhjetor '03	Mars '04	Qershor '04	Shtator '04
Objektivi	93.1	80.1	82.1	84.1
Parashikimi*	77.0	78.7	82.5	84.7
Diferenca	-16.1	-1.4	-0.4	-0.6

* Parashikimet për rritjen e objektivit të MBN dhe RNN gjatë vitit 2004 bazohen në rritjen e rezervës valutore bruto në masën 45 milionë USD dhe rritjen e parasë rezervë rreth 17.9 miliardë lekë deri në fund të vitit 2004.

Rritja vjetore e depozitave në lekë parashikohet të lejojë përballimin e nevojave të ekonomisë për mjete monetare të brendshme nga ana e bankave tregtare. Rritja e depozitave në lekë për vitin që vjen parashikohet 14.8 miliardë lekë ndërkohë që kërkesa e qeverisë dhe e sektorit

Rritja e MVN të sistemit bankar do të vijë kryesisht nga rritja e mjeteve valutore neto të Bankës së Shqipërisë, të cilat do të rriten me 7.1 miliardë lekë. Kjo përbën një rritje vjetore të MVN prej 7.2 për qind krahasuar me një rritje vjetore prej 2.2 për qind të parashikuar për vitin 2003.

Tabelë 7. Ecuria e likuditetit në sistem gjatë vitit 2004 (në miliardë lekë).

	T1	T2	T3	T4	2004
Rritja M2	5.8	6.7	7.0	10.2	29.7
Paraja jashtë bankave	1.7	3.1	3.2	6.9	14.9
Depozita në lekë	4.1	3.6	3.8	3.3	14.8
Financimi i deficitit nga Banka e Shqipërisë	1.9	1.9	1.9	1.9	7.5
Financimi i deficitit nga bankat	5.3	2.3	1.7	3.1	12.5
Kredi për ekonominë	0.5	0.5	0.5	0.5	2.0
Huamarrje nga Banka e Shqipërisë*	1.9	-0.8	-1.4	0.3	-/-

* Huamarrja nga Banka e Shqipërisë paraqitet me shenjë pozive; investimi i fondeve të lira pranë Bankës së Shqipërisë paraqitet me shenjë negative.

Rritja e parashikuar e rezervave valutore të Bankës së Shqipërisë gjatë vitit 2004 në masën 5.4 miliardë lekë do të jetë burimi kryesor i rritjes së MVN. E shprehur në valutë kjo rritje është 45 milionë usd. Një pjesë e madhe e kësaj rritjeje parashikohet të vijë si pasojë e blerjeve të valutës nga Banka e Shqipërisë.

absolute, ky kufi vlerësohet të jetë rreth 7.7 miliardë lekë. Programi monetar për vitin 2004 parashikon që Banka e Shqipërisë do të financojë deficitin buxhetor në vitin 2004 me 7.5 miliardë lekë. Financimi i deficitit buxhetor nga Banka e Shqipërisë është i nevojshëm për të bërë të mundur mbulimin e deficitit buxhetor në

Tabelë 8. Ndryshimi sipas tremujorëve i rezervës valutore bruto të B.Sh. (milionë usd).

Dhjetor 2003	T1	T2	T3	T4	Dhjetor 2004
973.8	0	15	20	10	1018.8

Pjesa tjetër prej 1.7 miliardë lekësh parashikohet të vijë nga rritja e rezervave të bankave tregtare në Bankën e Shqipërisë.

Mjetet valutore neto të bankave tregtare do të rriten me 1.5 miliardë lekë ose me 2.2 për qind. Rritja e MVN të bankave tregtare parashikohet në nivel të ulët megjithë rritjen vjetore prej 17.7 miliardë lekësh të depozitave në valutë. Nga kjo shumë, rreth 14.5 miliardë lekë pritet të shkojë

prani të një rritjeje të ulët të M2 dhe të depozitave në lekë. Programi monetar parashikon që rritja e depozitave në lekë gjatë vitit 2004 do të jetë e mjaftueshme për të mbuluar pjesën tjetër, prej 12.5 miliardë lekësh, të financimit të deficitit nga sistemi bankar.

Tabela e mëposhtme paraqet shpërndarjen sipas tremujorëve të financimit të deficitit buxhetor, për sistemin bankar.

Tabelë 9. Shpërndarja e financimit të deficitit sipas tremujorëve (miliardë lekë).

	T1	T2	T3	T4	2004
Financimi i sistemit bankar	7.2	4.2	3.6	5.0	20.0
- Banka e Shqipërisë	1.9	1.9	1.9	1.9	7.5
- bankat tregtare	5.3	2.3	1.7	3.1	12.5

për financimin e huamarrjes së sektorit privat, ndërkohë që pjesa prej 1.8 miliardë lekësh do të rrisë rezervat e bankave tregtare në Bankën e Shqipërisë.

KREDIA PËR QEVERINË

Gjatë vitit 2004, huamarrja e brendshme e qeverisë për mbulimin e deficitit buxhetor është parashikuar të jetë 22.6 miliardë lekë, ndërkohë që pjesa që pritet të përballohet nga të ardhurat nga privatizimi është rreth 2.8 miliardë lekë. Pjesëmarrja e institucioneve të tjera dhe e individëve në tregun e bonove të thesarit ka treguar shenja rritjeje në dy vitet e fundit. Për vitin e ardhshëm, financimi i deficitit nga ana e tyre pritet të arrijë vlerën prej 2.6 miliardë lekë. Financimi i deficitit buxhetor nga ana e sistemit bankar për vitin 2004 është parashikuar 20 miliardë lekë ose 2.3 për qind e PBB-së.

Ligji i lejon Bankës së Shqipërisë financimin e deficitit buxhetor deri në 5 për qind të të ardhuarve mesatare buxhetore normale të qeverisë gjatë tre viteve të fundit. Në vlerë

Financimi i Bankës së Shqipërisë është supozuar i njëjtë gjatë të katër tremujorëve, duke lejuar ecurinë e financimit nga ana e bankave tregtare sipas kërkesës së parashikuar nga qeveria. Gjithsesi, shpërndarja e financimit të Bankës së Shqipërisë mund të pësojë ndryshime në varësi të ecurisë së likuiditetit të sistemit bankar nga një tremujor në tjetrin.

KREDIA PËR EKONOMINË

Nevojat e bizneseve për huamarrje në mbështetje të bizneseve të tyre kanë treguar rritje në vitet e fundit. Kjo tendencë pritet të vazhdojë edhe në vitin 2004. Kredia për ekonominë gjatë vitit të ardhshëm është parashikuar të rritet me 16.5 miliardë lekë. Krahasuar me rritjen e tepricës së kredisë për vitin 2003, kjo rritje është rreth 3.6 miliardë lekë ose 28 për qind, më e madhe.

Parashikimi i kredisë për ekonominë për vitin 2004 bazohet në ecurinë e saj gjatë nëntë muajve të kaluar. Megjithë prezencën e një niveli të lartë likuiditeti gjatë këtij viti, rritja e tepricës së kredisë

në lekë ka qenë e ulët krahasuar me rritjen e saj në vitet e mëparshme. Gjatë vitit të ardhshëm, rritja e tepricës së kredisë në lekë pritet të vazhdojë me të njëjtat ritme, duke shënuar një rritje vjetore në vlerë absolute prej 2 miliardë lekësh.

Rritja e kredisë në valutë supozohet të jetë rreth 14.5 miliardë lekë ose 88 për qind e rritjes totale të kredisë për ekonominë. Diferenca mes normave të interesave të kredisë në lekë ndaj atyre në valutë, mendohet të jetë një nga arsyet kryesore të rritjes së ngadaltë të kredisë në lekë. Gjithashtu, niveli i lartë i likuiditetit të sistemit bankar gjatë vitit 2003 duket se nuk ka ndikuar në rritje të tepricës së kredisë në lekë.

Rritja e parashikimit të rritjes së teprisës së kredisë për ekonominë për vitin e ardhshëm bazohet në tendencën në rritje të nevojave për financim të sektorit privat. Ndërkohë, parashikimi për një rritje të ulët prej 2 miliardë lekëhs ose 12 për qind e kredisë në lekë, mbështetet në normat e larta të interesave të kredidhënies në lekë krahasuar me ato në valutë.

Supozimi i përafrimit të normave të interesave të kredidhënies në lekë dhe në valutë, do të ndryshonte edhe parashikimet për rritjen e tepricës së kredisë në monedhat përkatëse në të ardhmen.

INTERVISTA PËR GAZETËN "SHEKULLI", 29 DHJETOR 2003[1]
CANI: KRIZA POLITIKE, KOSTO TË RËNDA NË EKONOMI

Prej disa muajsh vendi është përfshirë në një krizë të stërzgjatur politike si pasojë e konflikteve brenda mazhorancës qeverisëse apo edhe si pasojë e një procesi të stërzgjatur zgjedhor në kryeqytet, që vazhdoi deri më datë 28 dhjetor. I gjithë ky proces krize politike, a ka efekte të drejtpërdrejta në ekonomi?

Eshtë e vërtetë se viti 2003 është shoqëruar me zhvillime intensive në skenën politike por për mendimin tim kjo tashmë nuk përbën një suprizë. Zhvillime të forta politike ka patur edhe vitet e kaluara dhe sigurisht që pasojat përgjithësisht bien mbi ekonominë. Sa më të shtrira në kohë të jenë krizat politike, aq më thellë "do të preken" treguesit ekonomikë dhe aq më i vështirë do të jetë procesi i reformës ekonomike drejt standardeve evropiane që synon Shqipëria. Mesazhi që unë do të desha t'u jap qytetarëve në lidhje me këtë problem është se faktori bazë për të cilin ata duhet të shqetësohen duhet të jetë ekonomia. Unë në gjykimin tim si ekonomist them se politika, diplomacia dhe fusha të tjera të jetës shqiptare mund të kenë luhatje, por këto mund të rregullohen shpejt. Ekonomia është si një makinë e madhe, e cila e ka shumë të vështirë për të marrë kthesën. Tani le t'i kthehemi asaj për të cilën më pyesni. Është e vërtetë se ka disa muaj që politika shqiptare po zjen ose ka konflikte të tejzgjatura. Megjithatë, deri në momentin që po flasim ndikimet e saj në ekonomi kanë qenë të një intesiteti të ulët dhe jo gjurmëlënës për treguesit kryesorë të zhvillimit të një vendi si Shqipëria. Dy janë arsyet që nuk kanë influencuar shumë, ose që kanë dhënë efekte të zbutura:

E para, është se shqiptarët janë të mësuar tashmë me këto luhatje të politikës, kanë fituar njëfarë "imuniteti" nga "gripi politik" i një tranzicioni, që do ta konsideroja të zgjatur dhe nuk kanë shfaqur shenja besimi që ato do të shndërrohen në goditje të forta. Madje, ende nuk besoj që do të ketë dhe në këtë rast ndonjë goditje shumë të fortë.

E dyta, ka të bëjë me faktin se ekonomia shqiptare, biznesi, po shkëputet gjithnjë e më shumë nga politika. Po sheh punën e tij, po ecën përgjithësisht pa pyetur për politikën. Në terma konkretë, situata ekonomike në vend është në rrugë të mbarë dhe thuajse të gjithë treguesit ekonomikë do të realizohen siç kanë qenë dhe objektivat e paracaktuar në fillim të vitit. Le të flasim më konkretisht: PBB-ja ose Prodhimi i Brendshëm Bruto, ishte parashikuar për t'u rritur me 6 për qind dhe mendohet se do të jetë po në kuotën 6 për qind.

Por, me gjithë optimizmin tuaj, nga ana tjetër Presidenti nuk ka dekretuar ende kabinetin e ri të kryesuar nga Kryeministri Nano dhe ende nuk ka garanci se qeveria do të marrë mazhorancën e votave në Kuvend. A mendoni se nëse kriza nuk zgjidhet shpejt, efektet në ekonomi do të jenë të konsiderueshme dhe të ndjeshme?

Duke përjashtuar komentet politike të cilat nuk më takon t'i vlerësoj nga këndvështrimi i Guvernatorit të Bankës Qendrore, më lejoni të ritheksoj se në afat të shkurtër krizat politike nëse nuk kthehen në kriza "popullore" nuk kanë efekte të ndjeshme në zhvillimin ekonomik në tërësi. Por, nëse konfliktet politike do të vazhdojnë të zgjaten pa "dritë në fund të tunelit" dhe nëse do të supozojmë se faktori politik nuk do të gjejë zgjidhje edhe në javët dhe muajt në vazhdim, atëhere sigurisht që kriza politike do të shoqërohet me kostot e veta në zhvillimin ekonomik të vendit dhe në ecurinë e reformave integruese. Koston më të madhe një krizë e tejzgjatur do ta jepte në ardhmërinë e zhvillimit ekonomik të vendit në periudha afatmesme dhe afatgjata. Ajo që mbetet si "produkt" i një krize politike të thellë e të zgjatur është reduktimi i

[1] Intervistoi: Blediana Beqiri

investimeve dhe ngecja e reformës ekonomike. Efektet mund të jenë edhe në fushën legjislative. Mungesa e miratimit të disa ligjeve do të krijojë deformim në përafrimin e legjislacionit shqiptar me atë evropian në fushat e përcaktuara dhe vakum kur ligjet diskutohen për herë të parë.

Pra, do të mbeten shumë ligje të parealizuara, të pamiratuara dhe doemos të pazbatuara. Një fat të madh për momentet që po kalon politika, do ta konsideroja miratimin e buxhetit të shtetit për vitin 2004, që në tërësi parashikon një zhvillim ekonomik të qëndrueshëm dhe një sërë reformash të kuadrit fiskal. Kriza me sa duket nga të dhënat empirike të viteve të fundit, mund të japë efekte negative te strukturat fiskale, tatimore dhe doganore, të cilat janë më të ndjeshme ndaj goditjeve të tilla. Disa efekte janë shfaqur që tani, por ato janë shumë të lehta.

Nëse kriza do të vazhdonte do të mblidheshin më pak të ardhura. Nëse këto të ardhura do të bien, atëhere do të goditen shpenzimet. Efekti tjetër do të shprehet në punën e administratës shtetërore. Mund të thuhet se administrata shtetërore përbëhet nga teknicienë, të cilët e dinë se politika do të ketë efekte në punën e tyre, çdo ndryshim i saj do të shoqërohet me ndryshime. Kështu që veprimtaria njerëzore duket sikur "paralizohet", duke u angazhuar tej mase me ngjarjet e politikës. Por, pasiguria politike jep efektet e saj në reduktimin e besimit të publikut dhe të biznesit, të cilat maten me indekset përkatëse. Banka e Shqipërisë është në proces të përgatitjes së këtyre indekseve, të cilat nënkuptojnë sinjale të rëndësishme për zhvillimin ekonomik të vendit. Krizat gjithmonë shoqërohen me rënie të konsumit pasi bie gatishmëria e konsumatorëve për të blerë, për të planifikuar investime apo shpenzime për shërbime. Nga ana tjetër, krizat e zgjatura frenojnë investitorët në sipërmarrjet e tyre pasi ato kanë parasysh se prodhojnë në një ambient jo të stabilizuar, me kërkesë dhe konsum të "rrudhur".

Ditët e fundit Guvernatori dhe Banka e Shqipërisë kanë qenë nën shënjestrat e politikës për sistemin e pagave. A mendoni se politika po i rikthehet cënimit të pavarësisë së Bankës Qendrore, pavarësi aq e lakuar vitet e fundit në Shqipëri dhe aq e shenjtë për vendet e zhvilluara?

Përjashtuar deklaratat e fundit në Kuvend dhe në media, të cilat gjithësesi nuk i kemi neglizhuar asnjëherë, dua të theksoj se gjatë vitit 2003 kemi qenë si më të qetë në sensin e ndërhyrjes së politikës në cënimin e pavarësisë së bankës qendrore. Sa i përket pyetjes tuaj, më lejoni të sqaroj për të gjithë ata që e dinë ose nuk e dinë, ose bëjnë sikur nuk e dinë, Guvernatori dhe nëpunësit e Bankës së Shqipërisë nuk paguhen nga buxheti i shtetit. Përkundrazi, Banka e Shqipërisë për vitin 2003 ka derdhur në buxhetin e shtetit mbi 8.3 miliardë lekë ose rreth 79 milionë dollarë në formën e fitimit të periudhës ushtrimore. Sigurisht që sistemi i pagave në Bankën e Shqipërisë vendoset mbi një bazë të argumentuar dhe vendimi i takon Këshillit të saj Mbikëqyrës, pasi në bazë të Kushtetutës (neni 161) dhe të ligjit "Për Bankën e Shqipërisë", Banka e Shqipërisë është e pavarur nga çdo pushtet tjetër për realizimin e objektivit kryesor të veprimtarisë së saj. Çdo subjekt është i detyruar të respektojë pavarësinë e Bankës së Shqipërisë, të mos kërkojë të influencojë te ndonjë anëtar i Këshillit Mbikëqyrës dhe të mos ndërhyjë në veprimtarinë e Bankës së Shqipërisë. Banka e Shqipërisë përgjigjet vetëm përpara Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, i cili ka zgjedhur Guvernatorin dhe Këshillin Mbikëqyrës.

Nga ana tjetër, duke parë nivelin e pagave në bankat e nivelit të dytë, ku një drejtor ekzekutiv paguhet deri në pesë fishin e pagës së Guvernatorit, rekomandimet e institucioneve financiare ndërkombëtare dhe eksperiencat e vendeve të tjera, sugjerojnë një tendencë në rritje të sistemit të pagave dhe jo presione për ulje apo për shkurtime. Argumenti kryesor është tërheqja dhe çka është më e vështirë mbajtja e një personeli të kualifikuar në nivele relativisht të përshtatshme për një bankë qendrore.

Gjithsesi, sa i përket çështjeve më të rëndësishme për një bankë qendrore, pasi kjo është një argument periferik për rëndësinë e zhvillimit ekonomik të një vendi, gjatë vitit 2003, Banka e Shqipërisë nuk ka konstatuar ndonjë formë presioni apo ndonjë formë të të ndikuarit të politikës mbi vendimmarrjen e saj.

Nga ana tjetër, intensiteti i lartë i ngjarjeve politike ka bërë që Banka e Shqipërisë të mbetet disi jashtë vëmendjes së politikës.

FJALA NË MBLEDHJEN E KËSHILLIT MBIKËQYRËS MBI NDRYSHIMIN E NORMËS SË INTERESIT DHE EFEKTET E PRIVATIZIMIT TË BANKËS SË KURSIMEVE, 30 DHJETOR 2003

1. MBI NDRYSHIMIN E NORMËS BAZË TË INTERESIT

Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë, në mbledhjen e tij më datë 30.12.2003, mori në shqyrtim ecurinë dhe parashikimet e inflacionit, faktorët që priten të ndikojnë në inflacion dhe ecurinë e kushteve monetare në ekonomi.

Nga analiza rezulton:

a) Zhvillimet e përgjithshme makroekonomike të vendit janë në përputhje me parashikimet e bëra. Siç është bërë e ditur edhe më parë, vlerësohet se prodhimi i përgjithshëm bruto të jetë rritur me 6 për qind, ndërkohë që inflacioni dhe deficiti buxhetor janë në nivele të kontrolluara.

b) Inflacioni, si një nga objektivat kryesorë të programit të zhvillimit të vendit dhe objektivi kryesor i Bankës së Shqipërisë, ka shfaqur ecuri pozitive gjatë njëmbëdhjetë muajve të parë të vitit duke rezultuar brenda objektivit 2 - 4 për qind të Bankës së Shqipërisë për vitin 2003. Ai pritet të jetë brenda objektivit edhe në muajin dhjetor, duke u luhatur rreth nivelit 3 për qind.

c) Faktorët që kanë ndikuar në sjelljen e inflacionit të këtij viti janë kryesisht faktorët tradicionalë ndërsa intensiteti i veprimit të tyre ka qenë brenda vlerave normale.

d) Zhvillimet në treguesit monetarë si: rritja e ofertës monetare dhe përbërja e saj, kursi i këmbimit, struktura e likuiditetit në ekonomi, si dhe niveli i përshatshëm i normave të interesit, kanë ndikuar në amortizimin e presioneve të shkaktuara nga faktorë të jashtëm mbi inflacionin.

e) Bankat tregtare, në ndjekje të politikës monetare të Bankës së Shqipërisë, kanë qenë aktive në drejtim të uljes së normave të interesit. Megjithatë, normat e ulëta të inflacionit kanë ndikuar në ruajtjen e normave reale të interesit në nivele pozitive. Ulja e normave të interesit gjatë vitit 2003 është shoqëruar me ulje të kostos së ndërmjetësimit të sistemit bankar.

f) Gjatë vitit 2003 deficiti buxhetor ka regjistruar një model pak më të ndryshëm krahasuar me vitet e tjera, ku spikat një ritmikë më normale në kryerjen e shpenzimeve buxhetore. Kjo është bërë më e theksuar në muajin dhjetor, i cili në ndryshim nga vitet paraardhëse nuk ka krijuar presion mbi politikën monetare.

Në këto kushte Këshilli Mbikëqyrës, vendosi uljen e normës bazë të interesit me 0.5 për qind. Pas kësaj uljeje, norma e interesit për marrëveshjet e riblerjes do të jetë 6.5 për qind.

Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë, me anë të këtij vendimi synon:

a) të ulë më tej koston e bankave në përgjithësi dhe çmimin e parasë në ekonomi, me qëllim që të nxitet akoma më shumë kreditimi i biznesit dhe rritja ekonomike;

b) të zbusë presionin që po ushtrohet mbi monedhën tonë, Lekun e cila prej disa kohësh po vazhdon të mbiçmohet si ndaj dollarit amerikan ashtu edhe ndaj euros;

c) të zbusë më tej diferencën midis përqindjeve të interesit për investimet në lekë me ato në valutë si në terma nominalë ashtu edhe në ato realë.

Duke analizuar skenarët e mundshëm të ecurisë së çmimeve të konsumit, Këshilli Mbikëqyrës vlerëson se ulja e normave të interesit nuk do të ndikojë negativisht në ecurinë e inflacionit për vitin 2004, ndërsa shpreh bindjen se një normë

më e ulët interesi do të jetë më afër nevojave të ekonomisë.

2. MBI EFEKTET E MUNDSHME TË PRIVATIZIMIT TË BANKËS SË KURSIMEVE

Privatizimi i Bankës së Kursimeve, një proces i cili u finalizua së fundi me përcaktimin e blerësit Raiffeisen Zentralbank, Austri, pritet të sjellë disa ndryshime në sistemin financiar në Shqipëri. Këto ndryshime do të ndodhin së pari në Bankën e Kursimeve, dhe nëpërmjet saj, në mënyrë direkte dhe indirekte, ato do të japin efektin e tyre edhe në sistemin bankar dhe financiar. Këto ndryshime, pritet të ndikojnë disi edhe në çështje të politikës monetare e të mbikëqyrjes bankare, që zbatohen nga ana e Bankës së Shqipërisë.

Në mënyrë më të detajuar, por ende paraprake, efektet e privatizimit të Bankës së Kursimeve në tregun shqiptar mund të përmblidhen më poshtë:

Së pari, Raiffesisen Zentralbank është një institucion financiar, i cili ofron shërbime bankare të larmishme për sistemin bankar shqiptar. Pra, pritet të sjellë në vend një numër të konsiderueshëm produktesh që mund të tërheqin publikun dhe biznesin.

Së dyti, do t'i jepet Bankës së Kursimeve një "fytyrë" të re në treg. Pritet që pronari i ri të investojë në mënyrë të qëndrueshme në infrastrukturën teknologjike të Bankës së Kursimeve. Banka pritet të lëvizë në mënyrë të qëndrueshme drejt procesit të kreditimit.

Së treti, marzhet e fitimit të sistemit bankar në periudhën e parë mund të ndikohen si në kahun e kostos ashtu edhe në kahun e të ardhurave.

Së katërti, investimet e Bankës së Kursimeve në portofolin e letrave me vlerë të qeverisë, gjykojmë se do të vazhdojnë të jenë relativisht të qëndrueshme. Kjo do të varej nga synimi i bankës për të kaluar në një sektor më fitimprurës siç është kreditimi i sektorit privat, në mënyrë më agresive apo më graduale.

Së pesti, prania e Raiffesisen Zentralbank në tregun shqiptar, do t'i jepte konkurrencës në sistemin bankar karakteristika më reale. Kjo do të thotë, që bankat e tjera private, më të vogla në madhësi dhe më pak aktive në produktet që ofrojnë, do të ridimensionohen në treg.

Së gjashti, hyrja e Raiffesisen Zentralbank në treg, pritet të shoqërohet edhe me interesimin, në periudha afatmesme, të investitorëve të huaj të rëndësishëm.

Së shtati, hyrja e Raiffesisen Zentralbank në treg do të sjellë një mentalitet edhe më të ri në administrimin e bankave, pra në të ashtuquajturën *corporate governance*.

Së teti, Raiffesisen Zentralbank do të jetë një zë më tepër në analizat ekonomike. Institucione të këtyre përmasave nuk mund të jenë pasive ndaj ngjarjeve ekonomike, por ato përpiqen t'i parashikojnë ato dhe t'iu paraprijnë me veprimet e nevojshme.

Së nënti, Raiffesisen Zentralbank vjen nga një shtet anëtar i Bashkimit Evropian. Kjo do të thotë që ajo zbaton parimet ndërkombëtare më të mira, në drejtim të standardeve ndërkombëtare të kontabilitetit dhe të auditimit. Këto janë të detyrueshme për t'u zbatuar, sipas direktivave të Bashkimit Evropian. Do të jetë një përvojë më e mirë për të gjithë sistemin bankar në Shqipëri dhe të gjithë aktoret e tjerë të sferës financiare, në kushtet kur synimi i përbashkët është aplikimi i këtyre standardeve në një kohë sa më të shpejtë.

Së dhjeti, larmia e produkteve që ofron Raiffesisen Zentralbank dhe që do të përpiqet t'i përdorë edhe në Shqipëri, do të kërkojnë (madje do të imponojnë) ndryshime në kornizën tonë ligjore dhe rregullative në sferën financiare. Kjo do të kërkojë angazhimin maksimal jo vetëm të Bankës së Shqiperisë, por të të gjitha insitucioneve shtetërore që veprojnë në këtë sferë, për të aplikuar në këtë drejtim standardet më të mira. Theksojmë, që ky do të ishte një proces i natyrshëm, të cilin hyrja e Raiffesisen Zentralbank në treg do ta përshpejtojë.

Së fundi, kërkohet përmirësimi i mëtejshëm i funksionit të mbikëqyrjes bankare, në kushtet

kur produktet dhe instrumentet që do të përdoren nga bankat do të shtohen dhe do të ndërlikohen.

Mbështetur sa më sipër, Banka e Shqipërisë shpreh bindjen se privatizimi i Bankës së Kursimeve përbën një hap të mëtejshëm në zhvillimet e sistemit bankar, rritjen e stabilitetit të tij dhe në rritjen e besimit të publikut dhe të klientëve në sistemin bankar.

Duke përfituar nga rasti në këtë takim të fundvitit me median ju falenderojmë për mbështetjen dhe bashkëpunimin e frytshëm gjatë vitit 2003 dhe ju uroj të gjithëve Gëzuar Vitin e Ri 2004! Suksese!

INTERVISTA PËR GAZETËN "KOHA JONË ", 30 DHJETOR 2003[1]
CANI: SUPRIZA JONË E VITIT 2004, KREDITIMI

Në mbyllje të vitit 2003, Guvernatori i Bankës së Shqipërisë Shkëlqim Cani bën një përmbledhje të zhvillimeve kryesore në ekonominë shqiptare, të zhvillimeve në sistemin bankar, në privatizimin e Bankës së Kursimeve si banka me pozicion dominues në ekonomi, të fushatës për kalimin e pagesave në banka etj..

Gjithashtu, Guvernatori ndalet gjerësisht në efektet pasprivatizim të Bankës së Kursimeve dhe në zhvillimet e pritshme në normat e interesit të depozitave, të kredive dhe të bonove të thesarit pas rënies së Bankës së Kursimeve në duart e austriakëve të Raiffeisen. Ç'pritet të ndodhë me financimin e borxhit të qeverisë nga sistemi bankar dhe a do të vazhdojë Banka e Kursimeve të jetë e pranishme në ankandet e bonove të thesarit apo do t'i drejtohet kreditimit të biznesit, siç edhe kanë premtuar drejtuesit e Raiffeisen Zentralbank? Po për vitin 2004 si do të ecë ekonomia shqiptare? Ç'pritet të ndodhë me normat e interesit dhe a do të fitojnë shqiptarët kulturën e munguar bankare për të bojkotuar veprimet me *cash* e për t'iu drejtuar sporteleve të bankave, siç ndodh rëndom në vendet e zhvilluara dhe në ato të rajonit? Ç'ndodhi me fushatën për çmimet dhe sa pritet të rezultojë norma e inflacionit në fund të vitit 2003?

1. Z. CANI, VITI 2003 SHËNOI PRIVATIZMIN E BANKËS SË KURSIMEVE NGA BANKA AUSTRIAKE RAIFFEISEN. ÇFARË PRITET TË SJELLË PËR SISTEMIN BANKAR DHE PËR POLITIKËN MONETARE TË BANKËS SË SHQIPËRISË KY PROCES?

Privatizimi i Bankës së Kursimeve, një proces i cili u finalizua me sukses me përcaktimin e blerësit Raiffeisen Zentralbank, Austri, pritet të sjellë ndryshime në sistemin financiar në Shqipëri. Këto ndryshime do të ndodhin së pari në Bankën e Kursimeve, dhe nëpërmjet saj, në mënyrë direkte dhe indirekte, ato do të japin efektin e tyre në sistemin bankar dhe në atë financiar. Këto ndryshime, pritet të ndikojnë edhe mënyrën e kryerjes së funksionit të mbikëqyrjes nga ana e Bankës së Shqipërisë.

Në periudhën afatmesme, ne shpresojmë që Banka e Kursimeve do të ketë efektin e shumëpritur të rritjes së kredisë ndaj sektorit privat, aq të nevojshëm për zgjerimin e mëtejshëm të këtij sektori dhe të prodhimit vendas. Por, nga ana tjetër, zgjerimi i kredisë pas privatizimit të Bankës së Kursimeve duhet konsideruar i lidhur ngushtë dhe me përmirësimin e faktorëve të tjerë, si kuadri ligjor, rregullator etj., që nuk varen thjesht dhe vetëm nga predispozicioni i Bankës së Shqipërisë apo i Bankës së Kursimeve për rritjen e kredisë për ekonominë. Një impakt tjetër i rëndësishëm që pritet të ketë privatizimi do të jetë trysnia e konkurrencës së sistemit bankar që do të ndikojë në koston e financimit të investimeve dhe në përmirësimin e sistemit të pagesave, në ofrimin e produkteve të reja bankare për qytetarët me një shtrirje të konsiderueshme në të gjitha rrethet etj..

Në aspektin e politikës monetare impakti më i rëndësishëm pas privatizimit të Bankës së Kursimeve pritet të jetë thellimi i tregjeve financiare, fillimisht i atij ndërbankar, që përbën një element të rëndësishëm për rritjen e eficiencës së mekanizmit të transmisionit, pra të asaj se si vendimet e Bankës së Shqipërisë përçohen në treg dhe në ekonomi. Por, emri i bankës së njohur Raiffeisen nënkupton edhe tërheqjen e investitorëve të huaj të interesuar për të investuar në Shqipëri dhe në rajon, sepse banka Raiffeisen konsiderohet lider në Evropën Qendrore dhe Lindore, ka degët e saj pothuajse në të gjitha shtetet e këtij rajoni. Nëse do të përmblidhnim, mund të themi se privatizimi i Bankës së Kursimeve, përveçse sjell një lojtar me reputacion në treg, mendohet të rrisë

[1] Intervistoi: Teuta Shamku

larminë e shërbimeve bankare, të rrisë aktivitetin kreditues, të sjellë një ridimensinonim të bankave të tjera në treg, një mentalitet edhe më të ri në administrimin e bankave, pra në të ashtuquajturën "*corporate governance*", standarde evropiane të bankingut pasi Raiffeizenbank vjen nga një vend anëtar i Bashkimit Evropian etj..

2. Ç'DO TË NDODHË ME ANGAZHIMIN E BANKËS MË TË MADHE NË VEND NË ANKANDET E BONOVE TË THESARIT DHE ÇFARË EFEKTESH MUND TË KETË NË NORMAT E INTERESIT TË BONOVE, TË DEPOZITAVE DHE TË KREDIVE?

Privatizimi i Bankës së Kursimeve, nisur nga pozicioni dominues i kësaj banke mund të mendohej se do të sillte çrregullime në sistemin bankar shqiptar. Por, duke u nisur nga emri i mirë i Raiftesen, reputacioni që ajo ka si dhe legjislacioni i hartuar për këtë qëllim (ligji i konkurrencës), mendojmë se, sjellja racionale dhe korrekte mbetet skenari më i mundshëm. Në afatin e shkurtër, kur mundësitë investuese dhe aktiviteti i kredive mendohet të mos jetë menjëherë agresive, alternativa investuese kryesore do të vazhdojnë të mbeten bonot e thesarit, gjë që mendohet të mos sjellë ndonjë ndikim të rëndësishëm në *yield*-et e bonove të thesarit për këtë arsye. Në lidhje me normat e interesit të depozitave, në mesatare, ndikimet do të jenë të vogla, pasi me reputacionin që ka kjo bankë ka mundësi që të vazhdojë të ruajë edhe për disa kohë pozicionin dominues, megjithë normat më të ulëta të interesit. Një pjesë e mirë e pozicionit dominues të kësaj banke është për shkaqe strukturore që lidhen me shpërndarjen më të gjerë të saj. Nëse do të shiheshin tendenca të rënies së pjesës së tregut të kësaj banke, kjo mund të reflektohej me një rritje të lehtë të normave të interesit të depozitave nga bankat që do të tentojnë të kapin pjesë të tregut nga ajo. Në përgjithësi, ky fenomen do të ishte i mirëpritur, pasi do të reflektonte një treg më konkurrencial. Normat e interesit të kredive ka mundësi të jenë të parat që mund të ndjejnë efektet e një tregu me konkurrencë në rritje. Pritjet që gradualisht, Raiffesen të pozicionohet në tregun e kredive dhe portofoli i konsiderueshëm i saj, mendohet që do të sjellë shpejt presione për rënie të normave të interesit të kredive, veçanërisht në monedhën vendase dhe klientët e mëdhenj. Nga pikëpamja e transmetimit të politikës monetare, pritjet e Bankës së Shqipërisë janë që mënyrat e reja të drejtimit dhe fokusi disi më i ndryshëm i kësaj banke do të bëjnë që Banka e Shqipërisë të ketë një partner më shumë në këtë drejtim, për perfeksionim të vendimeve të saj në lidhje me sinjalet monetare.

3. SI E VLERËSONI REAGIMIN E PUBLIKUT LIDHUR ME PROCESIN E PRIVATIZIMIT TË BANKËS SË KURSIMEVE?

Procesi i privatizimit të Bankës së Kursimeve, nuk konsiderohet i suksesshëm vetëm për vlerën e shitjes së bankës dhe për emrin e mirë të fituesit të tenderit ndërkombëtar. Reagimi pozitiv i publikut dhe në mënyrë të veçantë i klientëve në 36 degët e saj në të gjithë vendin ka shoqëruar thuajse të gjithë procesin gjatë këtij viti, ndryshe nga dy herët e tjera. Ky reagim mendohet se ka ardhur falë një procesi ristrukturimi të plotë e të suksesshëm të Bankës së Kursimeve, ndërgjegjësimit të personelit të saj dhe mjedisit akademik e politik për domosdoshmërinë e privatizimit, por edhe falë një angazhimi të përbashkët të Bankës së Shqipërisë, Ministrisë së Financave dhe sidomos të vetë Bankës së Kursimeve për sqarimin e publikut. Edhe media ka luajtur rolin e saj aktiv në drejtim të prezantimit sa më të plotë të të dyja bankave konkurrente duke ndjekur deri në qendrat respektive, Vjenë dhe Budapest respektivisht Raiffeisen dhe OTP-në.

4. GJATË VITIT 2003, BANKA E SHQIPËRISË NDËRMORI NJË FUSHATË KUNDËR SPEKULIMEVE ME ÇMIMET NË PRAG TË FESTAVE. MEDIA KA PARAQITUR OPINIONE TË NDRYSHME NËSE ISHTE APO JO E SUKSESSHME. ÇFARË SYNUAT ME KËTË FUSHATË?

Në fakt është ende shpejt për të bërë konkluzionet por gjithësesi fakti që ka një shkallë të lartë sensibilizimi në opinonin publik si dhe vendi që po i kushtohet në media, pavarësisht konkluzioneve të parakohshme, tregon se fushata ka prekur një çështje të rëndësishme për të cilën shqetësohen të gjithë e për rrjedhim dhe rezultatet nuk do të mungojnë. Që në embrion të fushatës, ekspertët e Bankës së Shqipërisë u munduan t'i jepnin përgjigje një sërë pyetjeve të lidhura me fushatën kundër

rritjes spekulative të çmimeve në prag të festave të fundvitit. Fushata u ndërmor duke njohur rolin e Bankës së Shqipërisë, si banka qendrore e vendit dhe në funksion të trasmetimit të vendimeve të saj te publiku dhe të detyrimit për ndërgjegjësimin e këtij të fundit. Fushata, në dimensionet kryesore të saj nuk ka "kontrollin" mbi çmimet apo kufizimin e konsumit/kërkesës, por informimin, ndërgjegjësimin dhe përgjegjësimin për një mision fisnik të mosrritjes spekulative të çmimeve në prag të festave të fundvitit. Banka e Shqipërisë nuk i tha konsumatorit "mos konsumo", por mos e tepro me kërkesën e tepërt që përkthehet në rritje çmimesh spekulative; Banka e Shqipërisë nuk i thotë biznesit mos fito, por shfrytëzo rritjen e konsumit dhe reduktimin e çmimit për të siguruar fitime më të qëndrueshme në gjithë gjatësinë kohore të muajve të vitit dhe jo vetëm në dhjetor; organeve tatimore u kërkuam të jenë të pranishme në treg për të krijuar besim te publiku dhe për të vjelë detyrimet fiskale në bazë të çmimeve reale të shitjes dhe jo ato të deklaruara, ndërsa organeve doganore të mbajnë siç kanë mbajtur të pandryshueshëm nivelin e çmimeve të referencës.

5. A MENDONI SE BANKA E SHQIPËRISË DO TË ARRIJË OBJEKTIVIN PËR INFLACIONIN NË FUND TË VITIT, NË INTERVALIN 2-4 PËR QIND, PASI DITËT E FUNDIT VIHET RE NJË RRITJE ÇMIMESH PËR ARTIKUJT USHQIMORË?

Gjatë muajit dhjetor kemi ndjekur me kujdes zhvillimet në çmimet e artikujve ushqimorë dhe bazuar dhe në informacionin që ndajmë me institucione të tjera shtetërore të specializuara, besojmë që inflacioni në fund të vitit, në bazë vjetore do të jetë në intervalin 2 - 4 për qind, aq sa ç'ishte objektivi i Bankës së Shqipërisë i shpallur që në fillim të vitit 2003.

6. GJATË KËTIJ VITI, BANKA E SHQIPËRISË KA BËRË PUBLIK EDHE PROJEKTIN PËR SISTEMIN E PAGESAVE RTGS. KUR PRITET TË FILLOJË NGA ZBATIMI DHE ÇFARË EFEKTESH MUND TË JAPË NË SISTEMIN BANKAR TË PAGESAVE?

Gjatë vitit 2003, siç jeni të informuar, Banka e Shqipërisë ka punuar edhe në drejtim të zbatimit në Shqipëri të sistemit kombëtar të pagesave ndërbankare dhe me vlerë të madhe ose siç quhet rëndom prej institucioneve ndërkombëtare, sistemin RTGS (Real Time Gross Settlement). Zbatimi i këtij projekti është pjesë e strategjisë së zhvillimit të Bankës së Shqipërisë dhe konsiderohet si një ndër prioritetet e zhvillimit dhe të konsolidimit të mëtejshëm të sistemit bankar shqiptar.

Vënia e tij në funksionim, në mënyrë të menjëhershme, rrit besueshmërinë e ekonomisë dhe të tregjeve financiare shqiptare në sytë e partnerëve dhe të investitorëve ndërkombëtarë. Përpjekjet për zbatimin e këtij projekti, po bëhen në kuadrin e ndihmës dhe të asistencës tekniko-financiare të Bankës Botërore, ndërsa në procesin e deritanishëm, Banka e Shqipërisë ka angazhuar, dhe do të vazhdoje në të njëjtën mënyrë deri në përfundimin e projektit, të gjithë sistemin bankar shqiptar. Efektet e drejtpërdrejta, të pritshme të sistemit të ri të pagesave ndërbankare në ekonominë shqiptare do të jenë:

- Rritja e stabilitetit dhe e besueshmërisë së sistemit bankar nga publiku vendas dhe i huaj, investitorët e huaj dhe organizmat ndërkombëtarë.
- Rritja e shpejtësisë së finalizimit të pagesave në vend, nxitja e zhvillimit të mëtejshëm të shkëmbimeve në vend dhe në mënyrë të veçantë i tregjeve financiare vendase.
- Krijimi i një infrastrukture bazë të domosdoshme për zhvillime të mëtejshme në sistemin kombëtar të pagesave.

Efekti për publikun, do të jetë krijimi i kushteve për finalizimin e pagesave, brenda ditës - pavarësisht nëse ato kryhen midis qyteteve dhe bankave të ndryshme. Për finalizimin e projektit si dhe për fillimin e operimit të sistemit, Banka e Shqipërisë si dhe bankat tregtare do të zhvillojnë në mënyrë të përbashkët testimin e sistemit. Funksionimi i tij i plotë pritet të jetë brenda janarit të vitit 2004, ndërkohë që po gjatë këtij muaji, Banka do të bëjë publik fillimin e operimit të sistemit si dhe përdorimin e tij nga sistemi bankar dhe nga publiku vendas.

7. SI KA ECUR FUSHATA KUNDËR CASH-IT NË EKONOMI DHE EFEKTET E PRITSHME NË REDUKTIMIN E PAGESAVE ME PARA NË DORË NË EKONOMINË SHQIPTARE. SI GJYKOHET ECURIA E FUSHATËS DHE EDUKIMI I PUBLIKUT ME BANKAT PËR VITIN 2004?

Fushata e iniciuar nga Banka e Shqipërisë gjatë vitit 2003 rezultoi e frytshme dhe me efekte pozitive, veçanërisht në drejtim të sensibilizimit të përgjithshëm për nevojën dhe mundësitë për reduktimin e *cash*-it. Më të rëndësishme mund të konsiderojmë nxitjen e institucioneve për të ndërmarrë masa dhe hapa konkretë dhe përfshirjen e trajtimit të kësaj çështjeje në programet dhe në planet e tyre. Ministria e Financave ka përfshirë tashmë si një objektiv të saj për vitin 2004, liberalizimin e llogarive dhe shërbimit të buxhetit në të gjitha bankat e nivelit të dytë brenda tremujorit të parë '04 dhe kalimin e pagave në llogari, për të paktën 10 për qind të punonjësve shtetërorë brenda shtatorit 2004. Banka e Shqipërisë po bashkëpunon me bankat e nivelit të dytë për të qenë të gatshme të presin këta klientë të rinj dhe të ofrojnë një shërbim cilësor dhe me përfitime të dyanshme. Është përfshirë në paketën e re fiskale detyrimi që çdo biznes duhet të ketë llogari bankare dhe çdo pagesë mbi 500 mijë lekë, të kryhet në bankë. Ministria e Ekonomisë ka programuar një numër aktivitetesh në rajone të ndryshme të Shqipërisë për edukimin e komunitetit të biznesit për avantazhet e zëvendësimit të *cash*-it. Po ashtu, një pjesë e mirë e bankave kanë përshpejtuar investimet në pajisje e rrjete ATM dhe kanë shtuar fushatën publicitare për shërbime bankare dhe oferta atraktive të pagesave jo *cash*. Mjaft pozitiv është bashkëpunimi midis KESH apo Albtelecom me bankat për mundësimin e pagesës direkte të faturave në bankë. Banka e Shqipërisë së bashku me institucionet partnere do ta vazhdojë më intensivisht luftën ndaj *cash*-it edhe gjatë vitit 2004, duke mbështetur iniciativat e institucioneve partnere por edhe duke investuar në ndërtimin e një sistemi pagesash efektiv, modern dhe në përputhje me standardet evropiane.

8. CILAT KANË QENË ZHVILLIMET KRYESORE NË OPTIKËN E GUVERNATORIT TË BANKËS SË SHQIPËRISË PËR VITIN 2003?

Ekonomia shqiptare gjatë vitit 2003 ishte më e mirë për shqiptarët krahasuar me një vit më parë. Treguesit kryesorë të ekonomisë shënuan zhvillime pozitive po të kemi parasysh qëndrueshmërinë në prodhimin bujqësor, zhvillimet optimiste në degët e shërbimeve, të industrisë dhe të transportit, rritjen e vëllimit të shkëmbimit tregtar, numrin e shtuar të turistëve, situatën e qëndrueshme dhe të favorshme energjitike, qëndrueshmërinë në prurjet valutore të emigrantëve e faktorë të tjerë. Në këtë mënyrë mendohet se produkti i brendshëm bruto do të shënojë një rritje 6 për qind, ndërkohë që viti 2003 vlerësohet se do të shënojë një vit tjetër me stabilitet të çmimeve të konsumit. Ashtu si dhe gjatë 3 - 4 viteve të mëparshme, parashikimet e Bankës së Shqipërisë flasin për një normë vjetore inflacioni brenda intervalit objektiv, 2 - 4 për qind.

Politika monetare e vitit 2003 ka vazhduar të jetë e kujdesshme, me tendenca zbutjeje. Kjo është pasqyruar në uljen e normave të interesit tre herë gjatë këtij viti. Duke ndjekur në vazhdimësi ecurinë e inflacionit dhe treguesit e likuiditetit të sistemit bankar, Banka e Shqipërisë ka ulur me 1.5 pikë përqindjeje në total (me 0.5 pikë përqindje në muajt prill, korrik dhe tetor) normën e marrëveshjeve të riblerjes gjatë vitit 2003, duke e çuar atë në fund të muajit tetor në nivel të njëjtë me nivelin e parakrizës së likuiditetit të vitit të kaluar.

Sistemi bankar reagoi në të njëjtën linjë me vendimet e Bankës së Shqipërisë, duke ulur normat e interesit të pranimit të depozitave, të bonove të thesarit dhe të transaksioneve në tregun ndërbankar. Zhvillimet monetare tregojnë se hemoragjia e depozitave në pranverën e vitit 2002, është tejkaluar plotësisht dhe Banka e Shqipërisë do të rishikojë politikën monetare në tendencë të zbutjes së mëtejshme në mbledhjen e rradhës së Këshillit Mbikëqyrës. Portofoli i kredisë së bankave për sektorin privat të ekonomisë është rritur me 10.1 miliardë lekë gjatë 10 muajve të parë të vitit, deri kur janë të dhënat operative. Gjatë kësaj periudhe, ekonomisë i janë dhënë 70.6 miliardë lekë kredi e re (rreth 660 milionë usd) ose 45 për qind më shumë se gjatë së njëjtës periudhë të vitit të kaluar. Gjithashtu, Banka e Shqipërisë ka qenë e pranishme në tregun valutor gjatë vitit 2003, duke blerë valutë. Aktiviteti valutor i Bankës së Shqipërisë ka ndihmuar në injektimin e likuiditetit në treg dhe ka zbutur tendencat mbiçmuese të lekut gjatë këtij viti.

9. SI E PARASHIKONI ZHVILLIMIN E EKONOMISË SHQIPTARE GJATË VITIT 2004?

Banka e Shqipërisë i publikon parashikimet kryesore të saj në programin monetar për vitin 2004, ku është mbajtur parasysh ruajtja e normës vjetore të inflacionit brenda kufijve 2 - 4 për qind. Në funksion të këtij objektivi, programi monetar synon kontrollin e rritjes së ofertës monetare në mënyrë që niveli i mjeteve monetare reale t'i përgjigjet nevojave reale të ekonomisë për një rritje ekonomike prej 6 për qind. Parashikimi i kërkesës së ekonomisë vazhdon të mbështetet në parashikimin e shpejtësisë thuajse konstante të qarkullimit të parasë. Ky parashikim, duke u nisur nga niveli i PBB-së nominale, është pika lidhëse midis inflacionit dhe rritjes së ofertës monetare (objektivi i ndërmjetëm).

Programi monetar garanton respektimin e objektivave sasiorë të Bankës së Shqipërisë dhe kontrollin e huamarrjes së brendshme të qeverisë në nivelin 2.7 për qind të produktit të brendshëm bruto. Raportet dhe struktura e likuiditetit në ekonomi duket se janë afër niveleve të tyre historike, ndërsa normat e interesit kanë patur tendencë rënëse gjatë vitit 2003. Në këto kushte, Banka e Shqipërisë, në varësi të ecurisë së mëtejshme të treguesve monetarë dhe atyre të inflacionit, mund të shikojë mundësinë e një uljeje të mëtejshme të normave të interesit, në mbështetje të aktivitetit ekonomik ose të objektivit të inflacionit. Duke përgjithësuar analizën e tendencave aktuale, mund të themi se gjatë vitit 2004 normat e interesit do të jenë përgjithësisht të qëndrueshme ose me tendencë rënëse.

Sistemi bankar parashikohet të plotësojë totalisht nevojat e sektorit privat për kredi në lekë. Nevojat e bizneseve për huamarrje kanë treguar rritje në vitet e fundit. Kjo tendencë pritet të vazhdojë edhe në vitin 2004. Kredia për ekonominë gjatë vitit të ardhshëm është parashikuar të rritet me 16.5 miliardë lekë.

Krahasuar me rritjen e tepricës së kredisë për vitin 2003, kjo rritje është rreth 3.6 miliardë lekë ose 28 për qind, më e madhe.

Sistemi bankar do të plotësojë edhe kërkesën e qeverisë për financimin e deficitit në masën 62.5 për qind të financimit total prej 20.0 miliardë lekësh. Banka e Shqipërisë mund të financojë deri në 5 për qind të mesatares së të ardhurave të qeverisë në tre vitet e fundit ose rreth 7.5 miliardë lekë. Gjatë vitit 2004, huamarrja e brendshme e qeverisë për mbulimin e deficitit buxhetor është parashikuar të jetë 22.6 miliardë lekë, ndërkohë që pjesa që pritet të përballohet nga të ardhurat nga privatizimi është rreth 2.8 miliardë lekë. Pjesëmarrja e institucioneve të tjera dhe e individëve në tregun e bonove të thesarit ka treguar shenja rritjeje në dy vitet e fundit. Për vitin e ardhshëm, financimi i deficitit nga ana e tyre pritet të arrijë vlerën prej 2.6 miliardë lekësh. Financimi i deficitit buxhetor nga ana e sistemit bankar për vitin 2004, është parashikuar 20 miliardë lekë ose 2.3 për qind e produktit të brendshëm bruto. Pra, përgjithësisht ekonomia do të ecë në shinat e shtruara gjatë vitit 2003, me zhvillime pozitive në drejtim të konsolidimit të mëtejshëm të sistemit bankar, tashmë të plotësuar me privatizimin e Bankës së Kursimeve dhe me efekte të konsiderueshme në zhvillimin e sektorit privat.

RAPORTI I ZHVILLIMEVE EKONOMIKE DHE MONETARE PËR GJASHTËMUJORIN E DYTË TË VITIT 2003

Ndonëse ende nuk kemi të dhënat përfundimtare të vitit 2003, përsëri vazhdon të fitojë terren ideja se viti që lamë, në përgjithësi, regjistroi rezultate të kënaqshme, të cilat i shërbejnë konsolidimit të mëtejshëm të ekuilibrit të përgjithshëm makroekonomik të vendit.

Ecuria e ekonomisë shqiptare gjatë vitit 2003 ka respektuar objektivat kryesorë makroekonomikë të përcaktuar në Strategjinë Kombëtare të Zhvillimit Ekonomik dhe Social. Të dhënat e mbledhura në lidhje me zhvillimet ekonomike të gjashtëmujorit të dytë përforcojnë vlerësimet më të hershme të Bankës së Shqipërisë, për një rritje të prodhimit të përgjithshëm bruto me rreth 6 për qind. Rritja ekonomike ka marrë jetë në kushtet e një inflacioni të ulët, të ruajtjes së disiplinës fiskale dhe të ecurisë sipas parashikimeve të sektorit të jashtëm të ekonomisë gjatë vitit 2003.

Vlerësimet për rritjen rreth 6 për qind të ekonomisë së vendit mbështeten nga disa tregues. Vëllimi i shitjeve totale në tremujorin e tretë u rrit me 8.4 për qind në krahasim me tremujorin paraardhës; në vazhdim të rritjeve të vërejtura edhe gjatë gjashtëmujorit të parë të vitit. Tashmë është kristalizuar ideja se prodhimi bujqësor në përgjithësi vlerësohet të jetë rritur me 3 për qind gjatë vitit 2003, krahasuar me 2.1 për qind në vitin 2002. Vëllimi i shitjeve në degën e industrisë, gjatë tremujorit të tretë të vitit 2003, ka shënuar një rritje prej 9 për qind krahasuar me të njëjtin tremujor të vitit 2002, duke regjistruar vazhdimisht ritme pozitive të rritjes tremujore gjatë vitit 2003.

Gjithashtu, situata energjitike është përmirësuar, duke u shoqëruar me rritje të prodhimit të brendshëm energjitik. Një sërë treguesish të tjerë si: rritja e kërkesës së brendshme për mallra; rritja e importit të makinerive dhe pajisjeve; rritja e vëllimit të transaksioneve me vendet partnere në tregtinë e jashtme; etj., mbështesin vlerësimet për një rritje sipas parashikimeve të degëve të turizmit, të transportit dhe të shërbimeve në përgjithësi. Nga kjo tablo dëshiroj të veçoj sektorin e ndërtimit, i cili vazhdon të jetë ndër sektorët më dinamikë të ekonomisë shqiptare. Tremujori i tretë i vitit 2003 shënoi një rritje të indeksit të vëllimit të shitjeve, prej 21.6 për qind krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2002, ndërkohë që indeksi i kushtimit në ndërtim është rritur me 3.47 për qind gjatë kësaj periudhe.

Banka e Shqipërisë gjykon se vlerësimet për një rritje të kënaqshme ekonomike mbështeten edhe nga ecuria e treguesve monetarë. Kështu, rritja me 44 për qind e kreditimit të ekonomisë gjatë 11 muajve të parë të vitit dhe rritja e depozitave me afat në sistem janë tregues të një aktiviteti të kënaqshëm ekonomik.

Viti 2003 është karakterizuar nga një aktivitet intensiv në sektorin e jashtëm të vendit, i shprehur në rritjen e konsiderueshme të të ardhurave dhe të shpenzimeve korente. Deficiti i llogarisë korente vlerësohet të ketë arritur në 8.5 për qind të PBB-së, duke u ulur me 0.5 pikë përqindjeje krahasuar me një vit më parë. Në veçanti, gjatë tremujorit të tretë të vitit 2003 deficiti i llogarisë korente ishte 106.6 milionë usd ose 12 për qind më i ulët sesa ai i tremujorit të tretë të vitit të kaluar. Megjithatë, duhet theksuar se deficiti tregtar në terma absolutë vazhdon të thellohet. Ai reflekton kryesisht rritjen e konsumit të ekonomisë shqiptare dhe nënvizon nevojën e rritjes së kapaciteteve prodhuese dhe konkurruese të ekonomisë shqiptare. Pavarësisht sa më sipër, pozicioni i përgjithshëm i bilancit të pagesave është pozitiv duke bërë që rezervat valutore të vendit të rriten vazhdimisht. Për herë të parë, në muajin dhjetor, niveli i përgjithshëm i tyre kaloi shifrën 1 miliard dollarë amerikanë, për të regjistruar më saktësisht 1.026 miliardë dollarë në fund të muajit dhjetor 2003.

Gjashtëmujori i dytë i vitit 2003 u karakterizua nga një inflacion i ulët, brenda objektivit të

Bankës së Shqipërisë. Vlera e inflacionit në muajin dhjetor ishte 3.3 për qind, duke respektuar objektivin e Bankës së Shqipërisë. Në nivel mesatar, çmimet e konsumit janë rritur me 2.37 për qind gjatë vitit 2003. Duhet theksuar se, zhvillimet e inflacionit përsëri u ndikuan nga prania e spekulimit në çmimet e produkteve ushqimore, edhe pse me intesitet më të ulët se vitet e mëparshme. Ashtu si dhe vitin e kaluar, Banka e Shqipërisë ndërmori një fushatë tjetër sensibilizuese, me qëllimin e vetëm për të minimizuar rritjen spekulative të çmimeve të konsumit në fund të vitit. Gjatë këtij muaji u regjistrua edhe ndryshimi i tarifave të telefonisë fikse, i cili ndikoi në rritjen e normës së inflacionit me 0.7 pikë përqindjeje. Megjithë këto fenomene, inflacioni ka rezultuar i ulët, duke reflektuar kontrollin e presioneve të kërkesës së brendshme si pasojë e politikave të shëndosha fiskale e monetare.

Ndonëse ende nuk disponohen të dhënat zyrtare për fundvitin 2003, duhet theksuar se ndryshe nga vitet e tjera, ky që sapo lamë u karakterizua nga një shpërndarje më racionale e shpenzimeve fiskale. Shpërndarja e kërkesave të qeverisë për huamarrje ka qenë më e njëtrajtshme gjatë vitit 2003, duke shmangur përqendrimin e financimit të deficitit në muajin dhjetor. Gjithashtu, zgjedhjet lokale të tetorit dhe klima e acaruar politike gjatë gjysmës së dytë të vitit nuk janë shoqëruar me përqendrime të shpenzimeve buxhetore apo me kompromentim të disiplinës fiskale. Së bashku me kufizimin e huamarrjes së brendshme të qeverisë në nivelin 2.7 për qind të PBB-së, ky ka përbërë një kontribut të çmuar të politikës fiskale për stabilitetin makroekonomik në përgjithësi, dhe për atë të çmimeve në veçanti. Nga ana tjetër, duhet të rritet kujdesi në drejtim të mbledhjes së të ardhurave buxhetore, të cilat vlerësohen të jenë realizuar në nivelin 92 për qind të atyre të planifikuara. Mosrealizimi i nivelit të parashikuar të të ardhurave ka rënduar mbi shpenzimet në përgjithësi, të cilat janë realizuar në nivelin 89 për qind të planit gjatë vitit 2003 dhe në shpenzimet kapitale në veçanti, të cilat ishin realizuar vetëm në masën 60 për qind të planit deri në muajin nëntor.

Zhvillimet monetare, gjatë gjashtëmujorit të dytë të vitit, kanë ecur në përputhje me parashikimet e Bankës së Shqipërisë. Oferta monetare është rritur sipas parashikimeve tona, duke qenë një ndër faktorët që ka kontribuar pozitivisht në ecurinë e inflacionit. Ritmi i rritjes së ofertës monetare ishte 9.7 për qind në muajin nëntor dhe të dhënat më të fundit operacionale tregojnë se ajo do të jetë afër parashikimit të Bankës së Shqipërisë edhe për fundin e vitit.

Në përgjigje të ecurisë pozitive të inflacionit dhe të pritjeve të tij si dhe të qëndrueshmërisë së treguesve monetarë, Banka e Shqipërisë ka ulur vazhdimisht normën bazë të interesit në ekonomi gjatë gjashtëmujorit të dytë të vitit 2003. Ulja e normës bazë të interesit u bë në tre hapa, në muajt korrik, tetor dhe dhjetor, për një efekt total prej 1.5 pikë përqindjeje. Niveli aktual i normës bazë të interesit është më i ulëti gjatë tre viteve të fundit. Ai ka ndikuar në uljen e normave të interesit të kredive dhe të depozitave në lekë si dhe të bonove të thesarit. Në mbështetje edhe të përmirësimit të situatës së likuiditetit në sistem, normat e interesit të kredive në lekë dhe të bonove të thesarit janë ulur më shumë se normat e interesit të depozitave në lekë, duke sjellë një ulje të kostos totale të ndërmjetësimit të sistemit bankar gjatë vitit 2003. Normat e interesit të depozitave me afat në lekë janë ulur me 1.9 pikë përqindjeje, *yield*-i i bonove të thesarit me 3.1 pikë përqindjeje ndërsa normat e interesit të kredive në lekë me 4.0 pikë përqindjeje (tabela 14). Dëshiroj të theksoj se shpejtësia e reagimit të bankave tregtare ndaj vendimeve të politikës monetare ka qenë e kënaqshme gjatë vitit 2003. Kjo ka bërë të mundur një transmetim më të shpejtë të vendimeve të politikës monetare në ekonomi.

Megjithë uljen e shpejtë të normave të interesit nga Banka e Shqipërisë, normat reale të interesit, kanë qëndruar në terma pozitivë si pasojë e ruajtjes së inflacionit brenda intervalit objektiv. Ky faktor ka kontribuar në ruajtjen e ekuilibrit monetar në ekonomi; në veçanti në ruajtjen e interesit për depozitimin e kursimeve në lekë dhe në kontrollin e normës së rritjes vjetore të agregatit M1, i cili ka edhe ndikimin më të madh në inflacion. Norma e rritjes vjetore të këtij të fundit ka qenë negative gjatë vitit 2003.

Rritja e depozitave dhe ulja e normave të interesit kanë qenë një kusht i nevojshëm monetar për mbështetjen në rritje të ekonomisë me kredi të vërejtur gjatë vitit 2003. Në përgjigje edhe të rritjes së aktivitetit ekonomik dhe të forcimit të lidhjeve të sektorit bankar me atë real të ekonomisë, teprica e kredisë është rritur me

11.4 miliardë lekë gjatë periudhës janar-nëntor të vitit 2003. Gjatë njëmbëdhjetë muajve të parë të vitit 2003 është lëvruar rreth 78 miliardë lekë kredi e re ose 44 për qind më shumë se gjatë së njëjtës periudhë të vitit të kaluar. Raporti i kredisë ndaj depozitave, megjithëse ende i ulët, është rritur me 1.8 pikë përqindjeje gjatë kësaj periudhe.

Banka e Shqipërisë ka përsosur instrumentet e politikës monetare gjatë vitit 2003. Në përgjigje të nevojave të tregut financiar shqiptar dhe të përpjekjeve të saj për përafrimin e këtyre instrumenteve me standardet e Banka Qendrore Evropiane, Banka e Shqipërisë ka ndryshuar disa aspekte të rezervës së detyruara, duke synuar rritjen e funksionit të saj si stabilizuese e normave të interesit në tregun ndërbankar dhe uljen e kostos që ajo përbën për bankat. Gjithashtu, Banka e Shqipërisë ka rivlerësuar edhe korridorin e normave të interesit të tregut ndërbankar, duke ulur kufirin e poshtëm të tij me anë të rritjes së diferencës së normës së interesit të depozitës njëditore me atë të repos.

Së fundi, dëshiroj të them dy fjalë edhe për ecurinë e sektorit bankar gjatë vitit 2003. Sistemi bankar paraqitet i shëndoshë në aspektin e rezultateve finaciare dhe dinamik në aspektin e zgjerimit të konkurrencës. Viti 2003 shënoi zgjerimin e komunitetit të bankave tregtare edhe me dy banka të tjera dhe hapjen e 14 degëve bankare në rrethe të ndryshme të vendit. Të gjitha këto tregojnë për një rritje të konkurrencës në sistem, e cila gjithsesi nuk ka prekur aftësinë e sistemit për të gjeneruar rezultate financiare pozitive. Fitimi i sistemit bankar arriti në 4.5 miliardë lekë në vitin 2003, kundrejt 3.9 miliardëve në vitin 2002.

Fundi i vitit 2003 shënoi një hap të rëndësishëm në drejtim të reformave në sistemin financiar të vendit. Pas disa përpjekjesh rresht, në muajin dhjetor 2003 u bë e mundur shitja e 100 për qind të aksioneve të Bankës së Kursimeve, bankës austriake Raifeissen Zentral Bank. Me këtë rast, dëshiroj të shpreh edhe një herë bindjen se ky zhvillim i mirëpritur në tregun financiar shqiptar do të ndikojë në zgjerimin e gamës së produkteve financiare të ofruara në treg, në rritjen e konkurrencës në tregun bankar dhe në rritjen e kreditimit të ekonomisë në një periudhë afatmesme.

BULETINI I LAJMEVE TETOR-DHJETOR 2003

Fjala e Guvernatorit Cani në Takimin e Klubit të Guvernatorëve, 13 Tetor 2003

Guvernatori i Bankës së Shqipërisë z.Shkëlqim Cani mori pjesë në edicionin e 10-të të Klubit të Guvernatorëve që u zhvillua nga në datat 10-11 tetor 2003 në Sinaia të Rumanisë. Temat kryesore e takimit të radhës të Klubit të Guvernatorëve ku bën pjesë edhe Shqipëria, ishin: zhvillimi i sistemit të pagesave dhe rëndësia e bankingut qendror, ndërtimi i institucioneve për të rritur kapacitetin bankar, komunikimi me publikun, një instrument kryesor i bankierëve qendrorë dhe zhvillimet në bankat qendrore që nga takimi i vitit të kaluar.

Në fjalën e tij, Guvernatori i Bankës së Shqipërisë, z.Shkëlqim Cani, paraqiti një panoramë të plotë të zhvillimeve të sistemit bankar shqiptar gjatë vitit të fundit. Sipas Guvernatorit, sistemi bankar shqiptar përbëhet nga 15 banka, një nga të cilat një është në proces privatizimi, dy janë me kapital të përbashkët, 11 janë banka ose degë të bankave të huaja dhe një është bankë private me kapital shqiptar. Gjatë tremujorit të dytë të vitit 2003, asetet e sistemit bankar janë rritur me 7 miliardë lekë ose 2 për qind.

Sa i përket zhvillimeve monetare, Guvernatori u shpreh se gjatë 9 muajve të parë të vitit 2003 indeksi i çmimeve të konsumit (inflacioni) shënoi një normë vjetore 3.9 për qind, nivel brenda objektivit të Bankës së Shqipërisë për një inflacion vjetor 2-4 për qind. Gjatë vitit 2003, Banka e Shqipërisë e ka ulur dy herë normën bazë të interesit (REPO) me 0.5 pikë përqindjeje dhe bankat e nivelit të dytë kanë reaguar në të njëjtin kah duke ulur normën e interesit të bonove të thesarit dhe të depozitave.

Monedha shqiptare ka qenë relativisht e qëndrueshme në kursin e këmbimit me euron dhe dollarin, dhe në muajin shtator ishte e vlerësuar 2.8 për qind ndaj euros dhe 12 për qind ndaj dollarit.

Kreditimi i ekonomisë, vazhdoi Guvernatori, ka shënuar zhvillime pozitive gjatë vitit 2003 duke arritur në 8.1 miliardë lekë e në mënyrë të veçantë gjatë muajit korrik, ku kredia e re shënoi 2.2 miliardë lekë.

Takimi i Klubit të Guvernatorëve konkludoi se një nga angazhimet kryesore të Bankës Qendrore Evropiane dhe Eurosistemit, është nxitja e zhvillimit horizontal të sistemit të pagesave. Banka Qendrore Evropiane dhe bankat qendrore të vendeve evropiane mund të garantojnë lehtësitë për të siguruar një sistem pagesash dhe kleringu midis komunitetit evropian dhe me vendet e tjera.

Referuesit nga Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim u shprehën se në rajonin e Ballkanit, stabiliteti i sektorit bankar dhe ruajtja e depozitave shtrojnë nevojën për një mbikëqyrje efektive të bankave qendrore, nevojën për një ligj falimentimi efektiv dhe për një mekanizëm sigurimi dhe rregullimesh për depozitat, të cilat duhet të zbatohen në të gjitha bankat, pavarësisht nëse janë private apo shtetërore.

Një temë e rëndësishme e takimit ishte edhe komunikimi i bankave qendrore me sektorin publik në funksion të rritjes së përgjegjshmërisë, pavarësisë, profesionalizmit dhe besueshmërisë së bankave qendrore.

Guvernatori Cani u shpreh se Banka e Shqipërisë ka bërë hapa progresive në drejtim të rritjes së transparencës së saj me publikun nëpërmjet rrugëve dhe mënyrave të ndryshme të sqarimit të rolit dhe të funksioneve të saj.

Ndërkohë, vijoi z.Cani, Banka e Shqipërisë ka filluar përgatitjet për hartimin dhe zbatimin e një strategjie të qartë të marrëdhënieve me publikun dhe me mediat me synim rritjen e konsiderueshme të transparencës së vendimeve të saj për publikun në funksion të një politike monetare efikase dhe

ndërtimin e modelit të një banke qendrore transparente, të përgjegjshme, të besueshme dhe të pavarur.

Gjithashtu, Guvernatori Cani pati një sërë takimesh me guvernatorë të bankave qendrore të Turqisë, Greqisë, Rusisë, Kirgiztanit dhe Serbisë.

Zëvendësguvernatori i Parë takon Misionin e FMN-se, 15 Tetor 2003

Zëvendësguvernatori i parë i Bankës së Shqipërisë, z.Fatos Ibrahimi dhe drejtues të saj zhvilluan me datë 15 tetor 2003 takimin prezantues me Misionin e vjeshtës EU1 të Fondit Monetar Ndërkombëtar, që vizitoi Shqipërinë të kryesuar nga z.Jan Kees Martijn, ekonomist në Departamentin Evropian të FMN-së dhe që shoqërohej nga përfaqësuesi i Përhershëm i Zyrës së FMN-së në Shqipëri, z. Jan-Peter Olters.

Temat kryesore të takimit ishin zhvillimet kryesore makroekonomike të vitit 2003, politika monetare e Bankës së Shqipërisë dhe zhvillimet në sektorin financiar.

Në fjalën e tij zëvendësguvernatori Ibrahimi u shpreh se Banka e Shqipërisë mbështetur në të dhënat më të fundit që gjithësesi nuk janë të plota, gjykon se objektivi për një rritje ekonomike 6 për qind për vitin 2003 është i arritshëm. Ky parashikim mbështetej kryesisht në zhvillimet më të fundit në sektorin bujqësor dhe të agroindustrisë. Gjithashtu, tregues optimistë për arritjen e objektivit të rritjes ekonomike ishin edhe: rritja e importit të makinerive dhe pajisjeve, rritja e numrit të turistëve që vizituan Shqipërinë gjatë sezonit të verës, rritja e konsiderueshme e kreditimit të biznesit, investimet në fushën e transportit, ecuria e sektorit të ndërtimit, rritja e kërkesës së brendshme dhe përmirësimet që janë vërejtur gjatë këtij viti në furnizimin me energji etj..

Duke parë në tërësi zhvillimet monetare, u shpreh z.Ibrahimi, Banka e Shqipërisë gjykon se parashikimet për inflacionin vjetor janë optimiste për respektimin e objektivit të Bankës së Shqipërisë për një normë inflacioni 2-4 për qind. Banka e Shqipërisë, u shpreh zëvendësguvernatori i parë, ka ulur dy herë gjatë këtij viti normën bazë të interesit (REPO) mbështetur në zhvillimet monetare, ndërkohë që gjysma e parë e vitit 2003 është shoqëruar me norma në rritje të inflacionit dhe pas muajit qershor inflacioni ka ardhur në rënie.

Në takim, vend të veçantë zuri edhe fushata e përbashkët e Bankës së Shqipërisë dhe Shoqatës së Bankierëve në Shqipëri për reduktimin e *cash* (parasë në dorë) në ekonomi dhe zhvillimin e mëtejshëm të sistemit të pagesave. Z. Ibrahimi u shpreh se janë ndërmarrë hapa të rëndësishëm në bashkëpunim me institucionet e tjera për pagesat e pagave dhe të faturave tatimore, doganore, të telefonisë, KESH etj., nëpërmjet bankave dhe nga ana tjetër Banka e Shqipërisë është në procesin e zbatimit të projektit të infrastrukturës për projektin e pagesave të mëdha në kohë reale (RTGS).

Guvernatori takon Misionin e Fondit Monetar Ndërkombëtar, 21 tetor

Guvernatori i Bankës së Shqipërisë, z.Shkëlqim Cani u takua ditën e hënë, datë 21 tetor, me Misionin e Fondit Monetar Ndërkombëtar EU1 që po viziton Shqipërinë në kuadër të misionit të vjeshtës të vitit 2003. Misioni kryesohej nga z.Hossein Samiei, dhe shoqërohej nga Përfaqësuesi i Përhershëm i Zyrës së FMN-së në Shqipëri, z. Jan-Peter Olters.

Temat kryesore të diskutimit kishin të bënin me treguesit kryesorë të zhvillimit ekonomik si: rritja e Produktit të Brendshëm Bruto (PBB), zhvillimet inflacioniste dhe politika monetare, privatizimi i Bankës së Kursimeve dhe zhvillimet e tjera në tregun financiar. Në fjalën e tij, Guvernatori Cani u shpreh se të dhënat nga sektori real i ekonomisë flasin për arritjen e parashikimit për një rritje ekonomike 6 për qind për vitin 2003 dhe nuk ka tregues që kërcënojnë këtë parashikim.

Sa i përket treguesit të inflacionit, u shpreh Guvernatori, Banka e Shqipërisë gjykon se objektivi për mbajtjen e tij brenda intervalit 2-4 për qind duket i arritshëm. Zhvillimet në tregun financiar, vijoi z.Cani, lidhen kryesisht me ecurinë e procesit të privatizimit të Bankës së Kursimeve dhe me gjetjen e aksionerëve për Bankën Kombëtare Tregtare. Banka e Shqipërisë ka mbështetur vendimet e Ministrisë së Financave në procesin e privatizimit të

Bankës së Kursimeve dhe sinjalet duken pozitive pasi disa banka të huaja kanë shfaqur interes për ta privatizuar atë. Ndërsa sa i përket Bankës Kombëtare Tregtare, Banka e Shqipërisë ka intensifikuar bisedimet me aksionerët e saj, BERZH dhe IFC, dhe përpjekjet për gjetjen sa më shpejt të investitorit të ri për aksionet e Bankës Kombëtare Tregtare që i takonin Kent Bank, por që tashmë zotërohen nga Fondi Turk i Sigurimit të Depozitave (SDRF), i cili është nën vartësinë e Agjencisë Turke të Rregullimeve dhe Mbikëqyrjes Bankare.

Një tjetër temë me interes për Misionin e Fondit ishte edhe fushata e Bankës së Shqipërisë për reduktimin e pagesave në dorë (cash) në ekonomi dhe zhvillimin e një sistemi modern pagesash. Guvernatori Cani u shpreh se Banka e Shqipërisë ka qenë në kontakte intensive me të gjithë institucionet që në veprimtarinë e tyre kanë lidhje me pagesat dhe së shpejti pritet të zhvillohet një takim i përbashkët me bankat, Ministrinë e Financave, Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve, Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave, kompanitë e telefonisë, të energjisë, të ujit, etj., për të evidentuar të gjitha hapat e nevojshëm për reduktimin e "*cash*"-it në ekonomi. Nga ana tjetër, konkludoi z.Cani, fillimi, brenda muajve të ardhshëm, i zbatimit të projektit të pagesave të mëdha në kohë reale (RTGS) pritet të ketë efekte të konsiderueshme në reduktimin e "*cash*"-it në ekonomi.

Guvernatori Cani në Konferencën Rajonale të EXIM Bank, 22 tetor 2003

Guvernatori i Bankës së Shqipërisë z.Shkëlqim Cani ditët e fundit mori pjesë në një Konferencë Rajonale të Evropës Qendrore dhe Juglindore të organizuar nga banka amerikane EXIM Bank (Eksport-Import Bank of United States) në Bled të Sllovenisë. Të pranishëm në konferencë ishin edhe përfaqësues të Ministrisë së Ekonomisë, të Agjencisë Kombëtare të Energjisë, të Drejtorisë së Përgjithshme të Aviacionit Civil, të Bankës Amerikane të Shqipërisë etj..

Tema kryesore e konferencës i referohej zhvillimeve ekonomike në rajonin e Evropës Qendrore dhe Juglindore duke iu adresuar kryesisht investitorëve dhe eksportuesve amerikanë mundësitë për investime dhe tregti në rajon. Konferenca konkretisht u fokusua në zhvillimet makroekonomike dhe të tregut bankar dhe mundësitë për investime të huaja direkte në Shqipëri, në Bosnje-Hercegovinë, në Bullgari, në Kroaci, në Maqedoni, në Rumani, në Serbi & Mal i Zi, në Çeki, në Hungari, në Poloni, në Sllovaki dhe në Sllloveni. Konferenca evidentoi programet e Qeverisë Amerikane për investime dhe eksporte në rajon, të cilat ishin menduar të rëndësishme për t'u diskutuar mes zyrtarët e qeverive, sistemit bankar, bizneseve të rajonit dhe eksportuesve e investitorëve amerikanë.

Në panelin e parë të Konferencës, Guvernatori i Bankës së Shqipërisë, z.Shkëlqim Cani, mbajti prezantimin mbi zhvillimet kryesore në ekonominë shqiptare dhe klimën për biznes në Shqipëri. "Sistemi bankar shqiptar, u shpreh z.Cani,- është në proces zhvillimi dhe konsolidimi. Nga viti në vit konkurrenca në sistemin bankar po vjen në rritje, sistemi bankar rezulton me fitim, po shtohet numri i bankave dhe degëve të tyre, Banka e Shqipërisë dhe bankat e nivelit të dytë po zhvillojnë një sistem modern pagesash, janë shtuar llojet e shërbimeve bankare, kreditimi i biznesit ka njohur rritje gjatë viteve të fundit, ndërkohë që sfida kryesore mbetet privatizimi i Bankës së Kursimeve".

Më pas, Guvernatori u shpreh se megjithë pengesat për zhvillimin e një ekonomie të mirëfilltë tregu, Shqipëria paraqet shumë mundësi për rritje ekonomike dhe për investime të huaja direkte. Infrastruktura e konsoliduar e tregut financiar, forcimi i zbatimit të ligjit, fuqia punëtore e kualifikuar dhe kultivimi i kulturës bankare, mund të nxisin investimet e huaja dhe vendase, nxisin zhvillimin ekonomik dhe do të ndihmojnë në krijimin e kushteve të nevojshme për zhvillimin e një ekonomie tregu të qendrueshme.

Gjatë qëndrimit në Sllloveni, Guvernatori Cani pati një sërë takimesh Presidentin dhe Zëvendëspresidentin Ekzekutiv të EXIM Bank, guvernatorëtdhe personalitete të shquara të institucioneve financiare, me të cilët shkëmbeu opinione mbi zhvillimet ekonomike dhe financiare në Shqipëri dhe më gjerë.

Guvernatori, takimin konkludues me Misionin e FMN-së, 28 tetor 2003

Guvernatori i Bankës së Shqipërisë, z.Shkëlqim Cani zhvilloi me datë 28 tetor, takimin konkludues me Misionin e Fondit Monetar Ndërkombëtar EU1 të kryesuar nga z.Hossein Samiei, që vizitoi Shqipërinë në kuadër të misionit të vjeshtës të vitit 2003. Guvernatori Cani dhe Misioni i FMN-së konkluduan se zhvillimet makroekonomike për vitin 2003 paraqesin përmirësim të treguesit të rritjes ekonomike nga 4.7 për qind në vitin 2002 në 6 për qind në vitin 2003 dhe mbajtjen e një norme inflacioni vjetor nën kontroll, në intervalin 2-4 për qind, falë një politike monetare të kujdesshme të Bankës së Shqipërisë.

Lidhur me instrumentet e politikës monetare, të dyja palët ranë dakord se norma bazë e interesit (REPO) do të mbetet instrumenti kryesor, ndërsa Banka e Shqipërisë do të gjykojë në mbledhjen e rradhës të Këshillit Mbikëqyrës mbi ndryshimin e mundshëm të normës së interesit.

Misioni i FMN-së vlerësoi se Banka e Shqipërisë ka mbajtur angazhimet që kanë të bëjnë me agregagët monetarë në Marrëveshjen Trevjeçare të Autoriteteve Shqiptare me Fondin Monetar Ndërkombëtar.

Guvernatori Cani u shpreh se përparësi për Bankën e Shqipërisë do të vazhdojë të mbetet stabiliteti financiar i vendit dhe se për këtë qëllim "Banka e Shqipërisë do të vazhdojë të forcojë mbikëqyrjen bankare" duke iu përmbajtur angazhimeve të marra në planin e zhvillimit të mbikëqyrjes bankare, pjesë e të cilit është edhe asistenca e ofruar nga institucionet e Bretton Ëood-sit".

Po kështu jashtë vëmendjes nuk do të lihen edhe hapa të tjerë të rëndësishëm, ku veçohet projekti RTGS. "Zhvillimi i sistemit të pagesave duke u fokusuar në zbatimin e projektit të Pagesave të Mëdha në Kohë Reale (RTGS) është një tjetër angazhim i Bankës së Shqipërisë, që synon reduktimin e pagesave në dorë (cash) në ekonomi dhe zhvillimin e konsolidimin e sektorit bankar dhe financiar në Shqipëri", u shpreh z.Cani.

Banka e Shqipërisë ul normën bazë të interesit, 30 tetor 2003

Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë, në mbledhjen e tij të fundit, pasi mori në shqyrtim ecurinë dhe parashikimet e inflacionit, faktorët që priten të ndikojnë në inflacion dhe ecurinë e kushteve monetare në ekonomi, vendosi uljen e normës bazë të interesit me 0.5 pikë përqindjeje.

Pas kësaj uljeje, norma e interesit e aplikuar për marrëveshjet e riblerjes dhe për marrëveshjet e anasjellta të riblerjes do të jetë 7 për qind.

Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë, në vendimin për uljen e normave të interesit, mbajti parasysh disa faktorë. Inflacioni, objektivi tjetër final i programit të zhvillimit të vendit, duket se është në rrugën e duhur. Më konkretisht, inflacioni vjetor në fund të muajit shtator 2003, rezultoi brenda intervalit objektiv 2 – 4 për qind, të shpallur prej Bankës së Shqipërisë. Faktorët që kanë ndikuar në sjelljen e inflacionit të këtij viti janë ata tradicionalë, ndoshta me të vetmin ndryshim që numri i shtuar i turistëve dhe rritja e eksporteve kanë ndikuar diçka më shumë në shtimin e presioneve mbi çmimet e mallrave ushqimorë. Ndërkohë tregues të tjerë si ata monetarë, kursi i këmbimit, deficiti buxhetor etj., kanë ndikuar në amortizimin e presioneve të shkaktuara nga rritja e kërkesës së jashtme. Megjithatë, edhe gjatë kësaj periudhe ekonomia shqiptare, si një ekonomi në proces transformimi vazhdoi të prodhojë goditje nga ana e ofertës, ku më e dukshme mbetet rritja e çmimeve të administruara të energjisë elektrike si dhe rritja e akcizave dhe e taksave në muajin qershor. Bazuar në modelet parashikuese të Bankës së Shqipërisë si dhe duke shpresuar në hapat që do të ndërmarrë Banka e Shqipërisë, në drejtim të sensibilizimit të opinionit për të minimizuar spekulimet me çmimet në fund të vitit, ekziston besimi se është i mundshëm realizimi i këtij objektivi.

Ulja e fundit e normës bazë të interesit me 0,5 për qind, që u aplikua në muajin korrik të këtij viti, nuk është pasuar me lëvizje të saj. Ndërkohë, Banka e Shqipërisë po ndjek me

vëmendje lëvizjet e përqindjeve të interesit në tregun financiar dhe në përputhje me zhvillimet në tregjet valutore, dhe me zhvillimet e pritshme në treguesit monetarë, në inflacion, në prodhim etj., është e mendimit se ekziston hapësira për një ulje të mëtejshme të përqindjes bazë të interesit 0.5 për qind, nga niveli aktual 7.5 për qind në 7 për qind.

Në përputhje me zhvillimet e fundvitit 2002 dhe të nëntë muajve të parë të vitit 2003, zhvillimet monetare janë karakterizuar nga një kthim i shpejtë i parasë në sistem. Ndërmjet specialistëve ekziston besimi se tashmë efekti i hemoragjisë së pranverës së vitit 2002 është tejkaluar, dhe se zhvillimet e fundit në zgjerimin e sistemit bankar e në përmirësimin e nivelit të shërbimeve të ofruara, përbëjnë premisa për të pasur një situatë më të përshtatshme të likuiditetit në sistem.

Banka e Shqipërisë është e bindur se me anë të këtij veprimi do të ulë më tej koston e bankave në përgjithësi dhe çmimin e parasë në ekonomi, duke stimuluar akoma më shumë kreditimin e biznesit me një kosto më të ulët

Takim për reduktimin e cash-it në ekonomi, 10 Nëntor 2003

Banka e Shqipërisë, Ministria e Financave, Ministria e Ekonomisë dhe Shoqata e Bankierëve organizuan me date 10 nëntor takimin e diskutimit me temë "Zëvendësimi i *cash*-it me Mjete Alternative Pagese: Avantazhet dhe Problemet", ku të pranishëm ishin edhe përfaqësues të komunitetit të biznesit, bankave të nivelit të dytë, organeve tatimore, doganore, Albtelekomit, KESH-it etj. Qëllimi i takimit ishte që të gjitha institucionet e pranishme të ndërmarrin angazhimet ligjore dhe administrative për rritjen e qarkullimit të parasë nëpërmjet sistemit bankar.

Në fjalën e hapjes, Guvernatori i Bankës së Shqipërisë z.Shkëlqim Cani u shpreh se "sistemi bankar në Shqipëri ka shënuar zhvillime pozitive të rëndësishme në drejtim të parametrave kryesorë si: shtimit të konsiderueshëm të numrit të bankave dhe të degëve të tyre, rritjes së numrit dhe cilësisë së shërbimeve bankare, ofrimit të mundësive të përdorimit të mjeteve bashkëkohore të pagesave, uljes së kostos së transaksioneve bankare etj., duke ofruar në këtë mënyrë mundësitë reale për reduktimin e veprimeve me lekë në dorë".

Guvernatori u shpreh se të gjithë do të përfitojmë nëse i drejtohemi sporteleve të bankave: Banka e Shqipërisë do të mund të zbatojë politika më efikase, bankat e nivelit të dytë do të përfitojnë më shumë klientë, biznesi do të përfitonte më shumë kredi dhe konsulencë, organet fiskale, tatimet dhe doganat, më shumë të ardhurave të siguruara dhe qeveria do të ishte më efikase në ndërmarrjen e poltikave buxhetore afatmesme për zhvillimin ekonomik të vendit dhe për rritjen ekonomike. Në tërësi, konkludoi z.Cani, publiku, do të përfitonte shërbime më cilësore të pagesave tek entet publike, Albtelekom, KESH, Ujësjellës, dhe pagesa pagash e pensionesh, në mënyrë më të qytetëruar e bashkëkohore, pa pritur rradhë të gjata e pa humbur kohë në sportele.

Takimin e përshëndetën Ministri i Financave z.Kastriot Islami dhe ai i Ekonomisë z.Arben Malaj. Referuesit u ndalën gjerësisht në faktin që Shqipëria karakterizohet nga një nivel i lartë i transaksioneve në *cash* në krahasim me ato nëpërmjet sistemit bankar. Kjo vërejtje mbështetet në nivelin e lartë të raportit të parasë jashtë bankave (PJB) ndaj ofertës monetare(M3) që karakterizon vendin tonë në krahasim me vendet e tjera si të zhvilluara ashtu dhe në tranzicion. Sipas bankierëve, nxitja e hyrjes së parasë jashtë bankave (cash-it) në sistemin bankar, do të rriste fluksin e informacionit për bankat, aq të nevojshëm për procesin e kredidhënies, si dhe do të rriste efektivitetin e politikës monetare. Për këto arsye, në takim u bënë një sërë propozimesh që kanë të bëjnë me ndryshimet e nevojshme në aktet ligjore e nënligjore që të arrihet:

- Detyrimi i të gjitha bizneseve për të paguar detyrimet ndaj shtetit (taksa, tatime, tarifa doganore) nepërmjet instrumenteve jocash të pagesës.
- Dhënia e pagave punonjësve shtetërore në një llogari bankare.
- Detyrimi i një kategorie të caktuar bizenesesh , siç mund te jenë "bizneset e mëdha" ose ''bizneset e tregtisë me shumicë'' që të kryejne çdo lloj transaksioni pagese (për blerje ose shitje) nëpërmjet sistemit bankar.

- Vendosja e bashkëpunimit me kompanitë utilitare dhe biznesin e madh, për të kryer shërbime, si pagesa të faturave me anën e debitimit direkt dhe të pagesës periodike.
- Marrëveshje ndërbankare për të mos aplikuar kosto për pagesat e brendshme.
- Marrëveshje ndërbankare për të mos aplikuar kosto dyfishe për një pagese-të hiqen kostot "incoming".
- Shtrirja kohore të orareve të shërbimeve në sportel dhe vendosja e sporteleve të pagesave elektronike (ATM).
- Aplikimi i skontove në kostot e pagesave me llogari kundrejt atyre me mjete *cash* etj.

Guvernatori takohet me Misionin e Asistencës Teknike të FMN-së, 11 nëntor 2003

Guvernatori i Bankës së Shqipërisë z.Shkëlqim Cani priti në një takim, përfaqësuesit e Misionit të Asistencës Teknike të Fondit Monetar Ndërkombëtar për Shqipërinë z. Patrik T. Downes dhe z. Paul L. Hilbers, nga Departamenti i Sistemeve Financiare dhe Monetare pranë FMN-së.

Takimi kishte si qëllim shkëmbimin e opinioneve mbi efikasitetin e asistencës teknike të ofruar deri më sot nga ky institucion, kryesisht asistencës së ofruar që nga viti 1997 dhe fushat e bashkëpunimit të mëtejshëm mes Bankës së Shqipërisë dhe Fondit Monetar Ndërkombëtar për çështje të ndryshme të bankingut qendror. Guvernatori Cani, e vlerësoi efikasitetin e asistencës teknike të FMN-së për Bankën e Shqipërisë, e cila ka ndihmuar në zgjidhjen e mjaft çështjeve të bankingut qendror, të hartimit të politikave monetare dhe nw parashikimin e regjimit të inflacionit. Ndërsa përfaqësuesit e Misionit të Asistencës Teknike të FMN-së u shprehën se projektet e asistencës për Bankën e Shqipërisë janë absorbuar me sukses, fakt ky që ka bërë që projektet për Bankën e Shqipërisë të konsiderohen si projekte-pilot në asistencën e FMN-së për bankat qendrore të rajonit. Sa i përket asistencës së ekspertëve të FMN-së për Bankën e Shqipërisë në të ardhmen, Guvernatori u shpreh se synimi kryesor i Bankës së Shqipërisë është aplikimi në të ardhmen i regjimit të shënjestrimit të inflacionit(Inflation targeting). Banka e Shqipërisë në regjimin e politikës monetare i referohet mbajtjes sipas parashikimeve (nën kontroll) të agregatëve monetarë(Monetary Targeting).

Gjatë pesë viteve të fundit, vijoi z.Cani, Banka e Shqipërisë ka parashikuar që në fillim të vitit inflacionin në nivelin 2-4 për qind dhe ka realizuar parashikimet. Por, sigurisht që synimi i Bankës së Shqipërisë pas pak vitesh është "Inflation Targeting" pasi Shqipëria është në procesin e integrimit evropian dhe Banka e Shqipërisë është e përfshirë intensivisht në synimin për t'u bërë pjesë e Bashkimit Monetar Evropian. Asistenca e FMN-së, konkludoi z.Cani, do të ishte shumë e vlefshme edhe në këtë proces të përafrimit të Bankës së Shqipërisë me Bankën Qendrore Evropiane, pjesë e së cilës do të jemi në të ardhmen.

Fushatë Kundër Rritjes Spekulative të Çmimeve, 21 Nëntor 2003

Me datë 20 nëntor 2003 në ambientet e Akademise së Arteve u çel fushata e Bankes së Shqiperisë kundër rritjes spekulative të çmimeve. Takimi në formën e një talk-show u drejtua nga Guvernatori i Bankes së Shqiperisë z.Shkëlqim Cani. Më poshtë gjeni pjesët kryesore të fjales së z.Cani.

"Në prag të festave të fundvitit, të gjithë jemi dëshmitarë të rritjes së çmimeve, që vjen si pasojë e rritjes së kërkesës së përgjithshme. Do të ishte absurde që tregtarët, prodhuesit, biznesmenët ata që ofrojnë shërbime të ndryshme, të mos mendojnë të pasurohen gjithnjë e më shumë. Do të ishte absurde gjithashtu, që një shtresë e caktuar njerëzish të mendojnë se vetëm shteti dhe shoqëria duhet të interesohen për zgjidhjen e problemeve të tyre ekonomike. Mendoj se është e drejtë të synohet drejt një fitimi të mbështetur në një logjikë të shëndoshë ekonomike, e cila si çdo logjikë tjetër është përpunuar dhe ka kaluar në mjaft përvoja të vendeve të ndryshme. E para, që ka të bëjë me traditën tonë të dikurshme. Me disa përjashtime të vogla në këtë sallë, të gjithë kujtojmë se ç'ndodhte me ne dhe me prindërit tanë në prag të festave të Vitit të Ri. Por, të gjithë harruam se në një ekonomi tregu,

për të cilën ne vetë flasim pa pushim, çdo veprim ka pasojën e tij, që në rastin tonë përkthehet në: kërkesë më e rritur do të thotë çmime më të larta. Kështu, secili mund të blejë sa i nevojitet për ditët e festave, se përsëri në treg do të vazhdojë të gjejë të gjitha që i duhen edhe të nesërmen edhe të pasnesermen, edhe të gjitha ditët e tjera.

Nga ana tjetër, nuk ka pse çdo artikull të blihet në momentin e fundit. E dyta, ka të bëjë me mundësitë për të festuar. Nga një pyetësor i ditëve të fundit, i bërë nga Banka e Shqipërisë, rezulton se rritja më e madhe e çmimeve vihet re në artikujt ushqimorë dhe në konsumin ushqimor jashtë shtëpisë. Nuk shihet për shembull, e njëjta rritje çmimesh në sendet e çmuara, në ato të kozmetikës, në parfumeri, në biletat e udhëtimit, në artikujt sportivë, në bileta kinemaje, teatri, koncertesh etj.. Një konkluzion tjetër që ka dalë nga pyetësori me qytetarët e Tiranës, rezulton se spekulimi bëhet nga tregtarët e shumicës. Por fitohet edhe pa "spekuluar" të themi me rritjen e kërkesës për produkte të caktuara. Dhe fitohet duke patur një mendim më të qartë ekonomik; duke punuar jo vetëm për momentin por edhe për të ardhmen; duke punuar jo vetëm për fitime materiale, por edhe për një emër të mirë; duke investuar kështu për të ardhmen e biznesit apo të tregtisë.

Si çështje e fundit është roli i shtetit dhe ndoshta disa çështje që kanë të bëjnë me edukimin tonë. Të gjithë ishim mësuar që shteti të kontrollonte rregullimin e përgjithshëm të tregut në masën që ai mundej. Se sa ky rregullim përputhej me kërkesën tonë dhe sa e plotësonte atë, tashmë është një argument tejet i konsumuar për të cilin nuk ia vlen të shpenzohen minutat e këtij takimi. Në momentin që flasim, shteti ka po ashtu një sërë detyrimesh të cilat, për të qenë të sinqertë, nuk është se gjithmonë i ka përmbushur maksimalisht. Pavarësisht sa më sipër, që shteti të realizojë rolin e tij klasik në një ekonomi tregu, përveç të tjerash i duhet në një masë jo të vogël bashkëpunimi i të gjithëve ne. Që ky bashkëpunim të funksionojë në të gjitha hallkat – tregtarë – biznes – prodhues – konsumatorë – duhet që secili të ketë të qartë, se të jetuarit në komunitet ka detyrimet e veta të pashkruara, të cilat, në një masë të caktuar, nuk mund t'i imponojë asnjë shtet. Derisa të gjithë së bashku, kemi marrë përsipër të jetojmë në një ekonomi tregu dhe të ndërtojmë një shoqëri të ekonomisë së përparuar duhet që, gjithashtu së bashku të pranojmë pjesën tonë të "fajit" në vështirësitë që i kemi shkaktuar njeri-tjetrit dhe të respektojmë ndershmërisht rregullat e lojës.

Guvernatori takohet me drejtorin ekzekutiv të ABPK, 26 nëntor 2003

Ditën e hënë, datë 8 dhjetor 2003, Guvernatori i Bankës së Shqipërisë z.Shkëlqim Cani u takua me drejtorin ekzekutiv të Autoritetit për Banka dhe Pagesa të Kosovës, z. Donat Branger.

Tema kryesore e diskutimeve, veç zhvillimeve më të fundit ekonomiko-financiare në Shqipëri dhe Kosovë, iu referua bashkëpunimit konkret mes Bankës së Shqipërisë dhe Autoritetit Bankar dhe të Pagesave të Kosovës, në bazë të Memorandumit të Bashkëpunimit mes dy autoriteteve.

Në fjalën e tij, Guvernatori Cani u shpreh se "Banka e Shqipërisë në strategjinë e saj të trainimeve për vitin 2004 do të përfshijë zhvillimin e seminareve intensive me Autoritetin Bankar dhe të Pagesave të Kosovës si në Tiranë ashtu edhe në Prishtinë, por edhe në seminare të përbashkëta të organizuara apo të mbështetura nga Banka Botërore, Fondi Monetar Ndërkombëtar etj.".

Sipas z.Cani, ekspertët e Bankës së Shqipërisë mund të shkëmbejnë me kolegët e Autoritetit Bankar dhe të Pagesave të Kosovës eksperiencat në fushën e mbikëqyrjes bankare, sistemit të pagesave, statistikave, teknologjisë, informacionit etj., ndërkohë që bashkëpunimi do të shtrihet edhe në fushën e organizimit të konferencave, të leksioneve dhe të studimeve të përbashkëta shkencore në fushën e bankingut qëndror dhe sistemit bankar në përgjithsi.

Nga ana e tij, z. Branger shprehu interes për shkëmbimin e eksperiencave dhe asistencën e Bankës së Shqipërisë në fushën e sistemit të pagesave pasi "cash"- pagesat në dorë përbëjnë një shqetësim real për sistemin bankar dhe për ekonominë në Kosovë.

Guvernatori Cani, duke u shprehur se ekziston pak a shumë i njëjti shqetësim edhe në Shqipëri, e njohu z.Branger me fushatën e Bankës së

Shqipërisë për pakësimin e "*cash*"-in në ekonomi. Në fund Guvernatori konkludoi se Banka e Shqipërisë dhe Autoriteti Bankar dhe i Pagesave të Kosovës do të bashkëpunojnë ngushtësisht dhe do të mund të krijojmë grupe pune të përbashkëta pasi çështjet janë pak a shumë të ngjashme dhe zgjidhjet e propozuara në fushatën e Bankës së Shqipërisë mund të shërbejnë edhe në rastin e Kosovës.

Banka e Shqipërisë ul përsëri me 0,5 për qind normën bazë të interesit, 30 dhjetor

Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë, mori në shqyrtim ecurinë dhe parashikimet e inflacionit, faktorët që priten të ndikojnë në inflacion dhe ecurinë e kushteve monetare në ekonomi.

Nga analiza rezultoi:

a)Zhvillimet e përgjithshme makroekonomike të vendit janë në përputhje me parashikimet e bëra. Siç është bërë e ditur edhe më parë, vlerësohet se prodhimi i përgjithshëm bruto të jetë rritur me 6 për qind, ndërkohë që inflacioni dhe deficiti buxhetor janë në nivele të kontrolluara.

b) Inflacioni, si një nga objektivat kryesorë të programit të zhvillimit të vendit dhe objektivi kryesor i Bankës së Shqipërisë, ka shfaqur ecuri pozitive gjatë njëmbëdhjetë muajve të parë të vitit duke rezultuar brenda objektivit 2 – 4 për qind të Bankës së Shqipërisë për vitin 2003. Ai pritet të jetë brenda objektivit edhe në muajin dhjetor, duke u luhatur rreth nivelit 3 per qind.

c) Faktorët që kanë ndikuar në sjelljen e inflacionit të këtij viti janë kryesisht faktorët tradicionalë ndërsa intensiteti i veprimit të tyre ka qenë brenda vlerave normale.

d)Zhvillimet në treguesit monetarë si: rritja e ofertës monetare dhe përbërja e saj, kursi i këmbimit, struktura e likuiditetit në ekonomi, si dhe niveli i përshtatshëm i normave të interesit, kanë ndikuar në amortizimin e presioneve të shkaktuara nga faktorë të jashtëm mbi inflacionin.

e)Bankat tregtare, në ndjekje të politikes monetare të Bankës së Shqipërisë, kanë qenë aktive në drejtim të uljes së normave të interesit. Megjithatë, normat e ulëta të inflacionit kanë ndikuar në ruajtjen e normave reale të interesit në nivele pozitive. Ulja e normave të interesit gjatë vitit 2003 është shoqëruar me ulje të kostos së ndërmjetësimit të sistemit bankar.

f) Gjatë vitit 2003 deficiti buxhetor ka regjistruar një model pak më të ndryshëm krahasuar me vitet e tjera, ku spikat një ritmikë më normale në kryerjen e shpenzimeve buxhetore. Kjo është bërë më e theksuar në muajin dhjetor, i cili në ndryshim nga vitet paraardhese nuk ka krijuar presion mbi politikën monetare.

Në këto kushte, Këshilli Mbikeqyres, vendosi uljen e normës bazë të interesit me 0.5 për qind. Pas kesaj uljeje, norma e interesit per marreveshjet e riblerjes do të jetë 6.5 per qind. Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë, me anë te këtij vendimi synon :

- të ulë më tej koston e bankave në përgjithësi dhe çmimin e parasë në ekonomi, me qëllim që të stimulohet akoma më shumë kreditimi i biznesit dhe rritja ekonomike;
- të zbusë presionin që po ushtrohet mbi monedhën tonë, Lekun i cili prej disa kohësh po vazhdon të mbiçmohet si ndaj dollarit amerikan ashtu edhe ndaj euros. Përveç kësaj synohet që:
- të zbuse më tej diferencën midis përqindjeve të interesit për investimet në lekë me ato në valutë si në terma nominalë ashtu edhe ne ata realë.

Duke analizuar skenarët e mundshëm të ecurisë së çmimeve të konsumit, Këshilli Mbikeqyres vlerëson se ulja e normave të interesit nuk do të ndikojë negativisht në ecurinë e inflacionit për vitin 2004, ndërsa shpreh bindjen se një normë më e ulët interesi do të jetë më afër nevojave të ekonomisë.

NGJARJET JURIDIKE

VENDIM I KËSHILLIT MBIKËQYRËS NR. 17 DATË 10.01.2003

Për disa shtesa dhe ndryshime në Statutin e Shërbimit Kombëtar të Punësimit, miratuar me vendimin nr. 42, datë 17.1.1998 të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e Statutit të Shërbimit Kombëtar të Punësimit". Statutit i janë bërë disa ndryshime në formulim dhe disa shtesa në "Detyrat dhe përgjegjësitë e zyrave rajonale dhe vendore të punësimit".

VENDIM I KËSHILLIT MBIKËQYRËS NR. 26. DATË 16.01.2003

Për një ndryshim në vendimin nr. 602, datë 2.11.2001 të Këshillit të Ministrave "Për çmimet tavan të shitjes së energjisë elektrike, për përdoruesit familjarë dhe jofamiljarë".

Sipas këtij vendimi ndryshohen çmimet e energjisë elektrike për "përdoruesit familjarë", për "përdoruesit specialë" dhe për "përdorues të tjerë".

VENDIM I KËSHILLIT MBIKËQYRËS NR. 49, DATË 23.01.2003

Për miratimin e Marrëveshjes, ndërmjet Qeverisë së Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Ukrainës, për nxitjen dhe mbrojtjen e ndërsjellë të investimeve.

VENDIM I KËSHILLIT MBIKËQYRËS NR. 50, DATË 23.01.2003

Për miratimin e Marrëveshjes, ndërmjet Qeverisë së Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Ukrainës, për bashkëpunim ekonomik dhe tregtar.

VENDIM I KËSHILLIT MBIKËQYRËS NR. 51, DATË 23.1.2003

Për miratimin e Marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë Federale të Republikës Federale të Jugosllavisë, për nxitjen dhe mbrojtjen e ndërsjellë të investimeve.

VENDIM I KËSHILLIT MBIKËQYRËS NR. 53, DATË 23.01.2003

